


EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6256
E premte, 5 mars 2021
çmimi 0.40 €

GAP-i: Kryetarët e komunave kanë plotësuar më pak se gjysmën e premtimeve të bëra | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ) KA SHPALLUR REZULTATET PËRFUNDIMTARE TË ZGJEDHJEVE TË 14 SHKURTIT | FAQE 4-5

LËVIZJA VETËVENDOSJE, 58 ULËSE NË KUVEND



Lëvizja Vetëvendosje (LV) është fituese e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 14 shkurtit. Sipas rezultatit përfundimtar të shpallur nga KQZ-ja, LV-ja ka fituar 49.95 për qind të votave (58 deputetë). Pas saj renditet PDK-ja me 16.90 për qind (19 deputetë), LDK-ja me 12.64 për qind (15 deputetë) dhe AAK-ja me 7.07 për qind të votave (8 deputetë). Në zgjedhjet e 14 shkurtit, Vjosa Osmani, e cila ka garuar në kuadër të listës së LV-së, ka marrë më së shumti vota, përkatësisht 300 788 vota, duke u bërë kështu personi më i votuar në historinë e Kosovës

ZEMAJ KËRKON RESPEKTIMIN E MASAVE NË FUQI KUNDËR COVID-19



Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka bërë thirrje që të respektohen masat në fuqi kundër Covid-19. Në takimim e Komitetit për vlerësimin dhe koordinimin e situatës epidemiologjike kundër Covid-19, Zemaj ka thënë se në situatën në të cilën

ndodhemi është e domosdoshme që në mënyrë strikte të respektohen të gjitha masat: distanca fizike, përdorimi i maskës, dezinfektimi dhe ajrosja e lokaleve, duke pamundësuar përhapjen eventuale të infeksionit dhe shmangien e përhapjes në hapësirat e mbyllura | FAQE 3



AUV KONFISKON 765 KILOGRAMË MISH QË NUK I PLOTËSOI KUSHTET PËR TREGTIM | FAQE 7

OPINION

PËRPEKJET PËR TA MOHUAR ATDHEDASHURINË DHE KOMBËTARIZMIN E ADEM DEMAÇIT ËSHTË MOHIM I VET QENIES SHQIPTARE! | F. 8-9

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA, Grupi Baca Adem



PSE KOSOVA DUHET TA KETË AMBASADËN NË JERUSALEM? | F. 11

Nga Mehmet PRISHTINA



AKTUALE

SHTATË TË VDEKUR DHE 591 RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË | F. 3



EKONOMI

BQK-ja E GATSHME TË NDIHMOJË PËR TEJKALIMIN E GJENDJES SË KRIJUAR NGA PANDEMIA | F. 8

DOGANA ARRIN 10 PËR QIND MË SHUMË TË HYRA SESA DY MUAJT E PARË TË VITIT TË KALUAR | F. 8



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTI
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Gjermania zgjat izolimin, por lehtëson disa masa

BERLIN, 4 MARS - Gjermania do t'i zgjasë masat e izolimit nga koronavirusi deri më 28 mars, por do t'i lejojë dyqanet jothelbësore dhe bizneset e tjera të rihapen në zonat me norma relativisht të ulëta të infeksionit.

Kancelarja Angela Merkel dhe guvernatorët e 16 landeve u pajtuan të mërkurën vonë për këtë balancë masash, pas rreth nëntë orë bisedimesh.

Rregullat e izolimit aktual do të zgjasin deri të dielën. "Duhet të bëjmë hapa drejt hapjes por, në të njëjtën kohë, hapa që nuk na kthejnë prapa", ka pohuar kancelarja Merkel para gazetarëve në Berlin. Ajo ka theksuar se ka shumë shembuj në Evropë për një valë të tretë dramatike.

Merkel u zotua se "pranvera e vitit 2021 do të jetë ndryshe



nga pranvera e një viti më parë". Gjermania ka regjistruar në total mbi 2.4 milionë raste me koronavirus dhe mbi 71 000 viktima. Shumica e dyqaneve atje janë të mbyllura qysh më 16 dhjetor. Restaurantet, baret dhe objektet sportive janë mbyllur nga 2 nëntori, ndërsa hotelet lejohen të punojnë vetëm për të akomoduar udhëtarë të biznesit.

Suedia heton terrorizmin si motiv i sulmit me thikë

VETLANDA, 4 MARS - Policia suedeze është duke hetuar terrorizmin si motiv të mundshëm prapa një sulmi me thikë në jug të Suedisë. Sulmuesi, në të 20-tat, u arrestua pasi u qëllua dhe u plagos nga policia të mërkurën, në qytetin Vetlanda. Ai plagosi tetë njerëz në lokacione të ndryshme në qendër të qytetit, i cili ndodhet rreth 275 kilometra në

jugperëndim të Stokholmit. Sipas spitalit lokal, tre të plagosur janë në rrezik për jetën.

Policia ka njoftuar se po e heton krimin si përpjekje për vrasje dhe se po konsideron lidhjet e mundshme me terrorizëm.

Ministri i Brendshëm i Suedisë, Mikael Damberg, i tha Radios suedeze se është e rëndësishme të priten hetimet,

përpara se të nxirren konstatime.

Policia nuk e zbuloi shtetësinë e sulmuesit të dyshuar, por tha se ai ka qenë i njohur për autoritetet për krime më të vogla. Kryeministri suedez, Stefan Lofven, tha se "dhuna e tmerrshme" është një kujtesë se "sa e dobët është ekzistenca jonë e sigurt". Forca shtesë të policisë janë vënë në patrullë në zonën e sulmit.



Navalny lajmërohet nga burgu: Gjithçka në rregull me mua

MOSKË, 4 MARS - Lideri i opozitës ruse, Aleksei Navalny, ka dërguar mesazhin e tij të parë nga burgu, pasi u transferua nga një qendër në Moskë në rajonin Vladimir, në mes të shkurtit. Në mesazhin e postuar në "Instagram", Navalny tha se është në Qendrën e Paraburgimit nr. 3

në qytetin Kolçugino dhe se po kalon mirë me shokët e qelisë. "Gjithçka është në rregull me mua", ka thënë Navalny, duke shtuar se ai dhe shokët e tij të qelisë duhet ta thajnë bukën, pasi nuk u lejohet të blejnë ushqim nga dyqani i qendrës së paraburgimit. Navalny është



arrestuar në Moskë në janar, menjëherë pasi është kthyer

nga Gjermania, ku është shëruar nga helmimi me agjent nervor. Ai është helmuar në muajin gusht, në një fluturim drejt Siberisë, ndërsa laboratorët perëndimorë kanë treguar se agjenti i përdorur në sulm ka qenë Novičok. Navalny ka fajësuar presidentin e Rusisë,

Vladimir Putin, për urdhërimin e sulmit ndaj tij, por Kremli e ka mohuar përfshirjen. Në fillim të shkurtit, një gjykatë në Moskë ka konstatuar se Navalny, gjatë kohës sa ka qenë në Gjermani, ka shkelur dënimin me kusht, të shqiptuar më herët për një rast të përvetësimit të fondeve.

Rregullatori i BE-së nis rishikimin e vaksinës ruse, 'Sputnik V'

BRUKSEL, 4 MARS - Rregullatori i barnave i Bashkimit Evropian thotë se ka nisur "rishikimin" e vaksinës kundër koronavirusit, të prodhuar në Rusi, "Sputnik V". Ky vendim po shihet si kyç drejt miratimit për përdorim të kësaj vaccine në 27 vendet e BE-së. Komiteti i ilaçeve i Agjencisë Evropiane të Barnave (EMA) do t'i rishikojë të dhënat nga studimet që po vazhdojnë të kësaj vaccine, derisa të ketë të dhëna të mjaftueshme klinike që ta miratojnë përdorimin e së njëjtës, tha EMA në një deklaratë për media më 4 mars.

Muajin e kaluar rezultatet paraprake të studimit të avancuar për këtë vaksinë u publikuan në gazetën mjekësore "The Lancet". Sipas të dhënave të publikuara, administrimi i dy dozave të "Sputnik V" tregoi efektivitet prej 91.6-përqindësh ndaj pacientëve që kishin simptoma të sëmundjes Covid-19. Kjo përqindje e efektivitetit është e përafërt me efektivitetin që kanë treguar dy vaksinat e tjera, ajo e "Pfizer/BioNTech" dhe vakcina e kompanisë "Moderna". "Rishikimi i



vazhdueshëm" ka për qëllim që ta përshpejtojë procesin e miratimit të vaksinës, duke i lejuar hulumtuesit që t'i dërgojnë gjetjet e tyre në kohë reale, edhe para se të dhënat finale të studimeve të jenë gati. Kjo agjenci evropiane deri më tani ka miratuar për përdorim vaksinat e "Pfizer/BioNTech",

"Moderna" dhe "AstraZeneca/Oxford" dhe pritet që gjatë javës së ardhshme të vendosë për miratimin ose jo të vaksinës së kompanisë "Johnson & Johnson". Po ashtu, rishikimet po vazhdojnë edhe për vaksinën "CureVac" dhe "Novavax".

Kirill Dmitriyev, kreu i Fondit për Investime Direkte ruse që ka financuar vaksinën "Sputnik V" dhe është përgjegjës për shitjen në mbarë botën, tha më 4 mars se Rusia do të jetë në gjendje që nga muaji qershor të sigurojë

vakcina për 50 milionë evropianë, nëse vakcina miratohet për përdorim nga EMA.

Dmitriyev, po ashtu, tha se Rusia pret që disa vende evropiane gjatë këtij muaji ta miratojnë vaksinën "Sputnik V". Më herët, gjatë këtij muaji, Sllovakia pranoi kontingentin e parë me doza të "Sputnik V", duke u bërë shteti i dytë i BE-së, pas Hungarisë, që ka marrë vakcina ruse, pavarësisht se kjo vakcinë ende nuk është miratuar nga rregullatori për barna i bllokut evropian.

Zemaj kërkon respektimin e masave në fuqi kundër Covid-19



Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka bërë thirrje që të respektohen masat në fuqi kundër Covid-19. Në takimin e Komitetit për vlerësimin dhe koordinimin e situatës epidemiologjike kundër Covid-19, Zemaj ka thënë se në situatën në të cilën ndodhemi është e domosdoshme që në mënyrë strikte të respektohen të gjitha masat: distanca fizike, përdorimi i maskës, dezinfektimi dhe ajrosja e lokaleve, duke pamundësuar përhapjen eventuale të infeksionit dhe shmangien e përhapjes në hapësirat e mbyllura

infeksionit Covid-19”, ka thënë Zemaj.

Në situatën në të cilën ndodhemi, Zemaj ka thënë se është e domosdoshme që në mënyrë strikte të respektohen nga të gjithë masat: distanca fizike, përdorimi i maskës, dezinfektimi dhe ajrosja e lokaleve, duke pamundësuar përhapjen eventuale të infeksionit dhe shmangien e përhapjes në hapësirat e mbyllura. “Dua ta falënderoj personelin shëndetësor, ekspertët tanë, Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik, tërë pjesëmarrësit në sistemin shëndetësor të Republikës së Kosovës, shtetet mike, organizatat globale shëndetësore dhe rajonale, donatorët vendorë e ndërkombëtarë, ambasadat dhe tërë personelin e angazhuar në zbatim të ligjit brenda dhe jashtë institucioneve të Republikës së Kosovës”, është shprehur ai.

Zemaj ka thënë se e vetmja rrugë kundër virusit aktualisht është parandalimi. “Parandalimi deri më tani pati sukses. Duhet ta vazhdojmë disiplinën. Ka vonesa për furnizim me vaksina si pasojë e kërkesave të mëdha në

tregun ndërkombëtar dhe si pasojë edhe e mosrealizimit të zotimeve edhe nga mekanizma ndërkombëtarë apo shtyrje të përmbushjes së zotimeve”, ka thënë ai.

Ministri Zemaj ka pohuar se një nga rrugët e sigurimit të këtyre vaksinave është edhe ajo nëpërmjet të mekanizmit COVAX, e cila në fillim të shkurtit kishte publikuar itinerarin e shpërndarjes së vaksinave për shtetet përfituese ku ishte edhe Kosova, duke vendosur shkurtin si afat të fillimit të alokimit, por që u shty. “Së fundi, ky mekanizëm ka publikuar orarin e alokimeve dhe listën e shteteve përfituese për periudhën shkurt-maj 2021 dhe Kosova është listuar në mesin e atyre vendeve që gjatë kësaj periudhe do të përfitojë 100 800 dozat e para. Kjo nuk nënkupton se kemi hequr dorë edhe prej iniciativave dhe marrëveshjeve apo pajtimeve që vaksinën ta sigurojmë edhe në rrugë të tjera, por vonesat kanë ndodhur përtej parashikimeve për shumë arsye”, ka deklaruar Zemaj.

Lidhur me situatën epidemiologjike ka raportuar drejtori i IKShPK-së, Naser

Ramadani, ndërkohë që për ngarkesën aktuale spitalore të ShSKUK-së ka folur drejtori i këtij shërbimi, dr. Valbon Krasniqi, i cili ka thënë se aktualisht në ShSKUK dhe njësitë e saj janë në trajtim 573 pacientë, prej të cilave 405 me Covid-19.

Sazan Ibrahim nga Asociacioni i Komunave të Kosovës ka pohuar se është kërkesë e kryetarëve të komunave që të vazhdohen masat në fuqi dhe se, sipas tyre, kategorizimi ka pasur sukses, derisa AUVK dhe Policia e Kosovës raportuan për numrin e inspektimeve dhe procesin e monitorimit të zbatimit të masave.

Nga këto institucione u kërkua që qytetarët të mos i shohin ato si institucione ndëshkuese, por si institucione që punojnë bashkë me të tjerat në preventivë kundër Covid-19.

Në këtë takim u diskutua edhe për mundësinë që inspektoratet të mbështeten më tej nga pakoja emergjente, derisa u theksua se nëse gjatë ditëve në vijim masat nuk respektohen dhe ka rritje të ndjeshme të numrit të infektimeve, masat mund të ashpërsohen dhe të kthehen disa kufizime.

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 MARS - Komiteti për vlerësimin dhe koordinimin e situatës epidemiologjike kundër Covid-19 ka kërkuar të enjten mirëmbajtjen e masave në fuqi kundër Covid-19 dhe respektimin e tyre të plotë.

Në takimin e këtij Komiteti të drejtuar nga ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj, u kërkua nga institucionet monitoruese dhe mbikëqyrëse që ta rrisin angazhimin për respektimin rigoroz të masave në fuqi përballë një rritjeje të numrit të infektuarve gjatë kësaj jave,

përderisa ditën e premte do të bëhet kategorizimi i ri i komunave sipas zonave (e kuqe, e verdhë dhe e gjelbër), bazuar në numrin e rasteve të Covid-19 brenda intervalit kohor prej një jave.

Ministri Zemaj ka thënë se situata me Covid-19 në Kosovë tregon për një rritje të rasteve javën e fundit për 26.8 për qind. “Para çfarëdo ashpërsimi të masave, apeloj sot te të gjithë qytetarët, institucionet dhe organizatat publike dhe private, për respektimin dhe ndërmarrjen e të gjitha masave të nevojshme për parandalimin, menaxhimin dhe kontrollin e

Shtatë të vdekur dhe 591 raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 4 MARS (ER) - Gjatë 24 orëve të fundit, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 3 674 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 591 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar shtatë raste të vdekjes si pasojë e këtij virusi.

Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Prizren dy raste (78, 68 vjeç), Ferizaj një rast (68 vjeç), Gjakovë një rast (83 vjeç), Mitrovicë një rast (74 vjeç), Prishtinë një rast (70 vjeç) dhe Viti një rast (72 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 71 344 raste nga 319 338 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 627 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 386 pacientë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 61 014 raste, kurse numri i rasteve aktive është 8 703. Rastet pozitive janë nga



komunat: Prishtinë 205 raste, Prizren 53 raste, Pejë 38 raste, Mitrovicë 31 raste, Ferizaj 30 raste, Fushë-Kosovë 24 raste, Gjakovë 20 raste, Gjiilan 17 raste, Vushtrri 17 raste, Deçan 15 raste, Podujevë 15 raste, Viti 15 raste, Kamenicë 14 raste, Obiliq 14 raste, Lipjan 12 raste, Istog 10 raste, Rahovec 9 raste, Skenderaj 7 raste, Drenas 6 raste, Dragash 5 raste, Kaçanik 5 raste, Malishevë 5 raste, Suharekë 5 raste, Graçanicë 4 raste, Klinë 4 raste, Shtime 4 raste, Novobërdë 3 raste dhe me nga një rast komunat Hani i Elezit, Junik, Klokot dhe Mamushë.



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ) KA SHPALLUR REZULTATET PËRFUNDIMTARE TË ZGJEDHJEVE TË 14 SHKURTIT

Lëvizja Vetëvendosje, 58 ulëse në Kuvend

Lëvizja Vetëvendosje (LV) është fituese e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 14 shkurtit. Sipas rezultati përfundimtar të shpallur nga KQZ-ja, LV-ja ka fituar 49.95 për qind të votave (58 deputetë). Pas saj renditet PDK-ja me 16.90 për qind (19 deputetë), LDK-ja me 12.64 për qind (15 deputetë) dhe AAK-ja me 7.07 për qind të votave (8 deputetë). Në zgjedhjet e 14 shkurtit, Vjosa Osmani, e cila ka garuar në kuadër të listës së LV-së, ka marrë më së shumti vota, përkatësisht 300 788 vota, duke u bërë kështu personi më i votuar në historinë e Kosovës

Në zgjedhjet e 14 shkurtit, Vjosa Osmani, e cila ka garuar në kuadër të listës së LV-së, ka marrë më së shumti vota, përkatësisht 300 788 vota, duke u bërë kështu personi më i votuar në historinë e Kosovës. Bartësi i Listës së PDK-së, Enver Hoxhaj, ka fituar 100 518 vota, pasuar nga Avdullah Hoti i LDK-së me 69 640 vota, dhe kreu i AAK-së, Ramush Haradinaj, me 41 406 vota. Personi i dytë më i votuar në Kosovë është kandidati për deputet i LV-së, Glauk Konjufca, i cili ka marrë 200 mijë e 641 vota. Kandidati i katërt që ka marrë mbi 100 mijë vota është kandidati për deputet i LV-së, Arben Vitia, i cili ka marrë 107 mijë e 313 vota. Sipas këtij

rezultati, LV-ja në zgjedhjet e 14 shkurtit ka fituar 438 334 vota, PDK-ja 148 296, LDK-ja 110 978 dhe AAK-ja 62 111 vota.

KQZ-ja i vlerëson të suksesshme zgjedhjet e 14 shkurtit

Kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka, ka bërë me dije se zgjedhjet e 14 shkurtit kanë qenë zgjedhjet e organizuara më së miri në historinë e zgjedhjeve të Kosovës.

Në konferencë për media, ku ka shpallur rezultatet përfundimtare, ajo ka thënë se KQZ-ja ka bërë punën e duhur në këtë proces. "Pavarësisht prej sfidave të mëdha, mes tyre

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 4 MARS - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) të enjten ka shpallur rezultatin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 14 shkurtit. Sipas këtij rezultati, Lëvizja Vetëvendosje ka shënuar fitore bindëse, duke siguruar 58 ulëse

në legjislaturën e re, ose 49.95 për qind të votave. Partia e dytë është renditur PDK-ja me 19 ulëse (16.90 për qind), e pasuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës me 15 ulëse (12.64) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me 8 deputetë (7 për qind). Prej komuniteteve, Lista Serbe ka fituar dhjetë ulëse në Kuvend. Nga dy ulëse në

Kuvendin e ri të Kosovës kanë fituar Partia Demokratike Turke e Kosovës dhe Iniciativa Rome. Ndërsa nga një ulëse kanë fituar Koalicioni Vakaf, Komuniteti i Bashkuar Adriana Hoxhiq, Partia e Re Demokratike, Partia Gorane, Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës dhe Partia e Ashkalinjve për Integrim.

edhe koha e shkurtër, pra më pak se 40 ditë në dispozicion të institucionit tonë për të organizuar zgjedhje, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka përbushur detyrimet që ka pasur, duke organizuar zgjedhjet më të mira në historinë e zgjedhjeve në vendin tonë”, ka deklaruar ajo, duke përmendur statistika të tjera të këtyre zgjedhjeve. “Numri i votuesve të regjistruar ka qenë 1 milion e 851 mijë e 927 votues. Numri i votuesve që kanë votuar në secilin vendvotim ka qenë 814 mijë e 122 votues. Numri i votuesve të cilët kanë votuar me kusht apo me postë ka qenë 89 mijë e 257 votues. Pjesëmarrja në votime ka qenë 48.77 për qind. Numri i pranuar fletëvotimeve të vlefshme është 877 mijë e 503 fletëvotime. Numri i fletëvotimeve të pavlefshme është 21 mijë e 532 fletëvotime dhe numri i fletëvotimeve të zbrazura është 5511 fletëvotime”, ka deklaruar Daka.

Pas shpalljes së rezultatit përfundimtar ka reaguar PDK-ja, duke e vlerësuar lart mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. Përmes një njoftimi të postuar në “Facebook”, PDK-

Rritet përfaqësimi i grave në Kuvend

Lëvizja Vetëvendosje si fituese e zgjedhjeve të 14 shkurtit ka vënë edhe një standard tjetër. Ky subjekt do të përfaqësohet me 58 deputetë në legjislaturën e re të Kuvendit, ndërkohë që 39.6 për qind janë gra në këtë listë fituese apo 23 deputete. Me ligj

është e përcaktuar që minimumi një e treta e deputetëve duhet të jenë gra. Më shumë se minimumi i kërkuar ka edhe AAK-ja që doli e katërta. Nga tetë deputetë, tri janë gra. Ndërkohë, PDK-ja si e dyta me 19 deputetë është pak

nën minimumin e kërkuar, 31.6 për qind të deputetëve i ka gra. Gjithsej gjashtë deputete do të jenë në grupin parlamentar të PDK-së. LDK-ja ka fiks aq sa është minimumi i përfaqësimit të grave me ligj, 33.3 për qind. Nga 15 deputetë, pesë janë gra.

ja ka vlerësuar se rezultati i zgjedhjeve të 14 shkurtit është pasqyrë dhe shembull i nivelit të lartë të demokracisë në vend. “Të nderuar anëtarë, simpatizantë dhe përkrahës të Partisë Demokratike të Kosovës, faleminderit për mbështetjen dhe përkrahjen e vazhdueshme! Faleminderit mijëra herë për secilën votë tuajën, për besimin e dhënë. Rezultatet e zgjedhjeve të 14 shkurtit janë pasqyrë dhe shembull i nivelit të lartë të demokracisë në vend. Votën tuaj PDK-ja do ta arsyetojë me punë dhe angazhim në të mirë të qytetarëve të Kosovës”, ka vlerësuar PDK-ja.

Pas shpalljes së rezultatit nga KQZ-ja, tani partitë dhe kandidatët për deputetë brenda 24 orëve mund t'i drejtohen Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), nëse kanë ankesa. Të drejtë ankesa ata më pas mund të bëjnë edhe në Gjykatën Supreme. Ankesat eventuale mund ta shtyjnë certifikimin e rezultatit zgjedhor, proces ky që i hap rrugë konstituimit të legjislaturës së tetë të Kuvendit të Kosovës.

Institucionet pritet të konstituohen së shpejti

Pasi KQZ-ja ta certifikojë

rezultatit e zgjedhjeve të 14 shkurtit, Kuvendi i Kosovës duhet të konstituohet brenda 30 ditësh. Sipas fituesve të këtyre zgjedhjeve, nuk pritet të ketë vonesa në konstituimin e kuvendit të ri dhe formimin e qeverisë së re.

Një ditë më parë lideri i LV-së, njëherësh kandidat për kryeministër, Albin Kurti, ka bërë me dije se i ka votat e nevojshme për formimin e qeverisë së re. “Do të jemi aty rrotull 60 deputetëve. Me siguri do ta kemi deputetin e komunitetit egjiptian Elbert Krasniqi. Me siguri do ta kemi deputeten e komunitetit boshnjak Emilia Rexhepi. Po

ashtu, do t'i kemi edhe disa të tjerë. Na nevojiten 61 vota. Do ta kalojmë numrin 61. Nuk do të kemi nevojë për kompromise me eksponentët e regjimit të vjetër, sepse populli e do të renë. Populli e ka bërë prerjen. Nuk e kemi ndërmend t'ia shkelim vullnetin e t'ia devijojmë dëshirën”, ka deklaruar Kurti në një konferencë për media mbajtur në Tiranë.

Pasi të konstituohet legjislatura e re, është në diskrecionin e presidentit që ta dekretojë kandidatin për kryeministër. Pas dekretimit, ekzekutivi i ri i Kosovës duhet të votohet brenda 15 ditësh. Sfida e parë e Qeverisë së re të Kosovës pritet të jetë zgjedhja e presidentit të ri. U. d. e presidentit, Vjosa Osmani, mund të qëndrojë në këtë pozitë vetëm deri në fillim të muajit maj. Sipas Kushtetutës së Kosovës, për zgjedhjen e presidentit nevojitet të paktën 80 deputetë. Kjo do të thotë se për këtë proces, nevojitet edhe pjesëmarrja e deputetëve të opozitës. Deri më tani partitë opozitare kanë bërë me dije se nuk do ta votojnë për presidente kandidaten e LV-së, Vjosa Osmani.

Osmani përmbyll vizitën dyditore në Zvicër

PRISHTINË, 4 MARS (ER) - Ushtruesja e detyrës e presidentit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka përmbyllur vizitën dyditore në Zvicër, ku ka qëndruar me ftesë të Parlamentit Zviceran. Përgjatë kësaj vizite, ajo është takuar me krerët e shtetit zviceranë, me të cilët ka diskutuar për bashkëpunimin ndërmjet dy shteteve, për ndihmën në fushën e zhvillimit dhe për identifikimin e fushave të reja në sferën e bashkëpunimit bilateral.

Osmani ka falënderuar për mikpritjen dhe takimet përmbajtësore presidentin e Këshillit Kombëtar, Andreas Aebi, presidentin e Senatit Zviceran (Këshillit të Shteteve), Alex Kuprecht, zëvendëspresidentin dhe ministrin e Punëve të Jashtme, Ignazio Cassis, nënkryetaren e parë të Këshillit Nacional të Zvicrës, Irene Kalin, Grupin e Miqësisë Kosovë-Zvicër dhe zyrtarë të tjerë shtetërorë.

Në këto takime është diskutuar mundësia për mbështetjen e sektorit të shëndetësisë nga ana e shtetit zviceran. Autoritetet shtetërore të Zvicrës kanë shfaqur gatishmërinë për ta mbështetur rrugën e Kosovës për në BE, sikurse edhe



anëtarësimin në organizata të ndryshme ndërkombëtare, një numër i madh i të cilave e kanë selinë në Zvicër. “Sundimi i ligjit, demokratizimi, siguria dhe transparenca e llogaridhënia mbeten objektiva të përbashkëta dhe aleatët tanë do të vazhdojnë të jenë pranë nesh për promovimin e tyre ashtu siç

kanë qenë edhe deri më tani. Gjersa, në fushën e zhvillimit, theksova se e ardhmja e Kosovës do të orientohet kah investimi në kapital njerëzor e në këtë drejtim bazë e çdo suksesi është investimi në arsim, në të cilin drejtim mora përkushtimin e partnerëve tanë për mbështetje në drejtim të prezantimit të

sistemit dual të edukimit në vendin tonë”, ka thënë Osmani. Në takimet me krerët shtetërorë të Zvicrës, Osmani ka diskutuar edhe për rëndësinë e bashkëpunimit rajonal, në kontekst të të cilit është përmendur dialogu Kosovë - Serbi. Ajo ka theksuar se epilogu i këtij dialogu duhet të jetë

njohja e ndërsjellë me kufijtë aktualë të Republikës së Kosovës. Po ashtu, është diskutuar edhe mundësia e bashkëpunimit në të ndërkombëtare dhe është paralajmëruar fillimi i një projekti për shkëmbimin e praktikave më të mira në fushën e parlamentarizmit.

Nënshkruhet kontrata për fillimin e punimeve për rehabilitimin e lumit Llukac

GJAKOVË, 4 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, drejtoresha e OJQ-së "SHE ERA", Mirlinda Kusari-Purrini dhe kompania "ArcProject", kanë nënshkruar kontratën për realizimin e aktivitetit "Rregullimi i infrastrukturës së lumit Llukac" në kuadër të projektit për ujë të pastër në Gjakovë dhe Kukës. "Jam i lumtur që sot është nënshkruar kontrata për një projekt tjetër jashtëzakonisht të rëndësishëm mes organizatës 'SHE ERA' dhe kompanisë përfutuese që është 'ArcProject' për fillimin e punëve në rehabilitimin e

shtratit të lumit Llukac. Në vitet që do të vijnë ose do ta buxhetojmë vetë vazhdimin për rehabilitimin e lumit Trakaniq (Llukac) ose do të sigurojmë fonde përmes donatorëve", ka thënë Gjini. Ky projekt implementohet në kuadër të Programit Ndërkufitar IPA II Shqipëri dhe Kosovë me partneritet në mes të Komunës së Gjakovës, Bashkisë së Kukësit, OJQ-së "SHE ERA" dhe OJQ-së "ACER".

Realizimi i tij do të zgjasë tri vjet dhe vlera totale financiare është 1,411,162.83 euro, kurse Komuna e Gjakovës do të participojë 134,000.00 euro.



Rrethohen varrezat e vjetra islame në qytetin e Kaçanikut



KAÇANIK, 4 MARS (ER) - Komuna e Kaçanikut, në bashkëpunim me misionin e OSBE-së në Kosovë, kanë përfunduar punimet për rrethimin e varrezave të vjetra islame në qytetin e Kaçanikut. Realizimi i këtij projekti është financuar

nga misioni i OSBE-së në Kosovë, ndërsa Komuna e Kaçanikut ka ofruar të gjithë mbështetjen e nevojshme logjistike dhe teknike gjatë procesit të punimeve. Pas përfundimit të punimeve, përfaqësues të Komunës së Kaçanikut

kanë vizituar varrezat e vjetra të qytetit, ku kanë theksuar se punimet janë realizuar sipas planit dhe afatit kohor. Komuna e Kaçanikut ka falënderuar misionin e OSBE-së në Kosovë për implementimin e këtij projekti.

Kanë filluar punimet për ndërtimin e trotuarit në Shkozë të Malishevës

MALISHEVË, 4 MARS (ER) - Kanë filluar punimet për ndërtimin e trotuarit në fshatin Shkozë të Komunës së Malishevës, i cili shtrihet përgjatë rrugës kryesore të fshatit. Punimet për ndërtimin e trotuarit i ka parë nga afër edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, i cili ishte i shoqëruar edhe nga

kryetari i fshatit. "Ndërtimi i trotuarit ka rëndësi të madhe për banorët e fshatit, më shumë për nxënësit të cilët duhet të ecin rrugës për në shkollë", ka thënë nënkryetari Berisha.

Edhe kryetari i fshatit e ka falënderuar komunën për këtë investim dhe për investimet e tjera në për fshatin Shkozë.



Bahtiri jep mirënjohje për mësime dhënësit

MITROVICË, 4 MARS (ER) - Në Qendrën e Kulturës "Rexhep Mitrovica", Drejtoria Komunale e Arsimit, për nder të 7 Marsit - Ditës së Mësuesit, ka organizuar një takim të përbashkët me mësime dhënësit, pensionistë dhe drejtorë të shkollave të Komunës së Mitrovicës. Në këtë takim mori pjesë edhe kryetari i komunës, Agim Bahtiri, dhe drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit, Ismet Ferizi, të cilët dhanë mirënjohje për mësime dhënësit më të dalluar dhe për ata që janë tash në pension për kontributin e tyre në procesin edukativo-arsimor.

Gjatë këtij takimi është shfaqur edhe një film dokumentar me

titull "Mbijetesat e shkollës shqipe", në të cilin u pasqyrua kontributi i mësime dhënësit për organizimin e mësimit në shtëpi shkolla përgjatë viteve '90.

Në fjalën e tij, kryetari Bahtiri ka falënderuar të gjithë mësime dhënësit për punën e tyre të palodhshme në edukimin dhe arsimimin e gjeneratave, duke thënë se të jesh mësime dhënë nuk është e lehtë, ka sfida dhe përgjegjësi të mëdha, por në të njëjtën kohë është nder dhe krenari të kontribuosh në edukimin e brezave të rinj. Po ashtu, kryetari Bahtiri theksoi se kur shënohet 7 marsi çdoherë kujtojmë sakrificat e mëdha në



GAP-i: Kryetarët e komunave kanë plotësuar më pak se gjysmën e premtimeve të bëra


EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 4 MARS - Instituti GAP ka publikuar vlerësimin më të fundit rreth përbushjes së premtimeve të kryetarëve të komunave nga zgjedhjet lokale të vitit 2017. Në këtë monitorim është përfshirë realizimi i premtimeve deri në dhjetor të vitit 2020. "Nga gjithsej 869 premtime të evidentuara nga Instituti GAP në 25 komuna të ndryshme të Kosovës, deri në muajin dhjetor 2020 janë përbushur 411 premtime, 186 premtime janë realizuar pjesërisht, 158 premtime kanë filluar të përbushen, ndërsa për 114 premtime nuk është evidentuar ndonjë nismë në përbushjen e tyre. Shikuar sipas përqindjes, nga 869 premtimet e dhëna, deri në dhjetor të 2020-s janë përbushur vetëm 47 për qind të premtimeve. Pjesa më e madhe e premtimeve janë përbushur në fushën e mirëqenies sociale 74 për qind, pastaj renditet fusha e administratës 58 për qind, në fushën e ekonomisë 57 për

qind, në fushën e bujqësisë 56 për qind, në fushën e shëndetësisë 50 për qind, në fushën e shërbimeve publike 47 për qind dhe në fushën e infrastrukturës 45 për qind", thuhet në raportin e GAP. Fusha ku më së paku janë përbushur premtimet janë fusha e urbanizimit, e arsimit dhe ajo e kulturës. Në këtë përditësim nuk është përfshirë Komuna e Podujevës, që pati zgjedhje të jashtëzakonshme në nëntor. "Komuna që nuk është përfshirë kësaj here në përditësim është ajo e Podujevës, ku në fund të nëntorit të 2020 janë mbajtur zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar komune. GAP ka monitoruar premtimet e kandidatëve për kryetar komune dhe ka evidentuar se kryetari aktual i kësaj komune ka dhënë 44 premtime në fusha të ndryshme. Instituti GAP bën monitorimin e përbushjes së premtimeve në 26 nga 38 komunat, ngaqë 12 nga kryetarët aktualë nuk kanë zhvilluar fushatë zgjedhore më 2017 (Skenderaj, Mamusha dhe komunat me shumicë serbe)", thuhet në raportin e GAP-it.

Niveli i përbushjes së premtimeve

sipas periudhave të përditësimit



AUV konfiskon 765 kilogramë mish që nuk i plotësojnë kushtet për tregtim

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 4 MARS - Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) ka ndërmarrë një aksion në qytetin e Prizrenit për largimin nga tregu të mishit dhe produkteve të mishit pa dokumentacion.

Zëdhënësi i AUV-së, Lamir Thaçi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se AUV ka konfiskuar 765 kilogramë mish që nuk i plotësojnë kushtet për tregtim në këtë qytet. "Në një koordinim të plotë të inspektorëve veterinarë të AUV-së dhe inspektorëve lokalë të Komunës së Prizrenit u inspektuan të gjitha mishoret në këtë qytet. Në secilin rast ku inspektorët hasen në mish dhe produkte mishi pa dokumentacion, i njëjti u ndalua për qarkullim (konfiskua) dhe do të asgjësohet në ditët në vazhdim. Nga ky



aksion ka rezultuar me konfiskim të një sasive prej 765 kilogramë mish dhe nënprodukte mishi (mish i freskët, mish i ndarë

mekanikisht, mish në faza të përpunimit, mish i bluar, suxhuk, qofte etj.) të cilat nuk i plotësojnë kushtet për tregtim", ka thënë Thaçi.

Ai ka thënë se kushtet teknike sanitare të mishoreve në nivel të përgjithshëm ishin të mira. "Në disa raste janë dhënë vërejtje për përmirësim brenda

afateve kohore. Të gjitha mishoret ishin të regjistruara pranë AUV-së. Furnizimi me mish kryesisht ishte nga tregoret të licencuara, të cilat posedonin dokumentacion për origjinën e mishit. Te një mishore është hasur mish pa origjinë, pa dokumentacion, dhe e gjithë sasia është ndaluar për qarkullim deri në asgjësim. Sasitë e tjera të nënprodukteve të mishit të ndaluara në mishore të tjera kryesisht ishin për mungesë të licencës për përpunim të produkteve të cilat trajtohen termikisht. AUV në ditët në vazhdim do ta bëjë asgjësimin e gjithë sasisë së ndaluar", ka thënë ai. Thaçi ka paralajmëruar se aksione të tilla do të ketë në gjithë Kosovën, për largimin nga tregu të produkteve të cilat nuk i përbushin kriteret ligjore për tregtim. "Synimi ynë mbetet mbrojtja e konsumatorëve", ka thënë Thaçi.

FSK-ja merr mirënjohje nga Oda e Mjekëve e Kosovës

PRISHTINË, 4 MARS - Oda e Mjekëve e Kosovës i ka ndarë mirënjohje Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) për punën e palodhshme gjatë pandemisë Covid-19, me motivacionin:

"Mirënjohja ndahet për profesionistët shëndetësorë, vullnetarët dhe stafin mbështetës, për kontributin e veçantë të dhënë në luftë me pandeminë Covid-19".

Mirënjohjen në emër të FSK-së e pranoi koloneli dr. Xhevdet Tahiraj, drejtor i Departamentit të Mjekësisë në Ministrinë e Mbrojtjes nga kryetari i Odës së Mjekëve të Kosovës, dr. Pleurat

Sejdiu. Ky i fundit ka falënderuar FSK-në për angazhimin e palodhshëm në ndihmë të institucioneve shëndetësore të Kosovës gjatë pandemisë Covid-19.



Përpyjekjet për ta mohuar atdhedashurinë dhe kombëtarizmin e Adem Demaçit është mohim i vet qenies shqiptare!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA, Grupi Baca Adem

Kush dhe pse në këtë kohë po merret me Adem Demaçin: Në historinë e re të shqiptarëve dhe të Shqipërisë e sidomos të Kosovës, sa i përket angazhimit për çështje kombëtare, pa e bërë edhe një ditë të vetme pushim, duke u sakrifikuar deri në vetëflijim apo mohim të vetvetes, si frymëzues i dhjetëra e mijëra patriotëve që vepruan, përballuan çdo torturë dhe vdiqën nën torturë në burgjet e ish-Jugosllavisë dhe të Serbisë, ata që e themeluan, luftuan dhe ranë heronj në luftën çlirimtare të së lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovës, nuk mund ta gjeni një tjetër të tillë përveç në personalitetin e pazëvendësueshëm të Bacë Adem Demaçit. Personalitetet e mëdha njerëzore, historike, kombëtare, morale dhe politike identifikohen dhe përcaktojnë, duke i vultur periudha dhe procese të tilla historike. Të rrallë janë ata që e kanë fatin apo, unë e them vendosmërinë, ta marrin përgjegjësinë historike për këto procese. Baca Adem Demaçi, në këtë aspekt është rast unik, i papërsëritshëm, i pazëvendësueshëm dhe pa mundësi të riinkarnimit. Edhe ne kemi bërë nga pak burg politik por... është e papërfillshme me atë që e ka bërë Baca Adem, në aspektin politik dhe kombëtar sikur edhe komandanti legjendar Adem Jashari, në aspektin e rezistencës dhe luftës së armatosur. Ne kemi qenë shoqëruar, ndihmues, vijues dhe, në një mënyrë, sakrifikuar, por si Adem Demaçi nuk ka dhe më nuk do të ketë në mesin e shqiptarëve. Është një rregull i pashkruar se personalitetet e fuqishme dhe me ndikim, për së gjalli nuk respektohen sa duhet, nëse nuk instrumentalizohen nga politika, ngaqë i marrin si rrezikues të posteve apo pushtetit politik, mirëpo pas vdekjes apo ikjes në amshim, në të shumtën e rasteve bëhet vlerësimi objektiv dhe i ndahet vendi që i takon. Edhe në këtë aspekt Baca Adem është rast unik, për së gjalli ia ngushtuan dhe i pamundësuan qasjen në

institucione që i takojnë para se të gjithë të tjerëve, edhe nëse bëhen bashkë, e sulmuan dhe e pushkatuan publikisht përmes mediave dhe intrigave, ia organizuan një ceremoni mortore, që më shumë e fyente personalitetin e Bacës se që e nderonte dhe, për një kohë, e lanë të qetë. Tash, pasi u bë pjesë e përjetësisë njerëzore, botërore dhe shqiptare, mbetjet nga sistemi sllavist, jugosllav dhe serb, që i kishin shërbyer me aq pasion dhe përlulje apo zgjatjet e tyre biologjike, përsëri kanë filluar të merren me personalitetin e të pavdekshmit Adem Demaçi. Nuk mbeti merr nënëbishtit apo horr njerëzor dhe moral, pa e "vlerësuar", siç thonë ata, Adem Demaçin, madje duke ia mohuar edhe burgun mbi 28-vjeçar në llogoret e ish-Serbisë dhe ish-Jugosllavisë. Po këto karikatura morale, që shqipen e përdorin vetëm pasi u çlirua Kosova, tash si gjuhë të parë, kurse më parë e kishin gjuhë shtetërore, gjuhë të nënës dhe gjuhë të babës, gjuhë të besimit, bindjeve politike dhe kombëtare, e kishin gjuhën serbe. Fillimisht u përpoqën ta vënë në një kontekst konfrontues me Ibrahim Rugovën ndonëse Baca Adem, thuaja deri në fillim të luftës, e kishte përkrahur Rugovën. Dallimet midis Bacës Adem dhe Ibrahim Rugovës nuk ishin politike apo kombëtare, por ishin në mënyrën se si duhet të arrihen ato qëllime. Baca Adem ishte për aktivizëm, fillimisht të rezistencës paqësore e, pastaj, edhe të armatosur, kurse Ibrahim Rugova ishte për aktivizëm vendnumëruar, ku edhe ujku është i lumtur sikur që edhe qengjat mbesin të paprekur. Ishte dhe është shumë e qartë se në të njëjtin vend nuk mund të mbijetojnë dhe bashkëjetojnë ujku me qengjat. Shaip Beqiri bëri mirë që e bëri publike një letër që Baca Adem ia kishte dërguar në vitin 1992 Ibrahim Rugovës ku i drejtohet me vëlla dhe i jep përkrahje të plotë. Edhe unë e kam pasur atë letër dhe letra të tjera që e dëshmojnë se Baca Adem kurrë nuk e ka sfiduar Ibrahim Rugovën në luftë për pushtet, por se ka dashur të jetë katalizator për shpejtimin e veprimeve të Rugovës e që Rugova nuk e bëri këtë. Ka ende për të shkruar. Me kohë, besoj.

Grupi Baca Adem: Jemi një grup shokësh që u frymëzuam dhe u rritëm kombëtarisht dhe politikisht në frymën dhe personalitetin e Bacës Adem Demaçi dhe që e patëm fatin, për dallim prej të tjerëve, që të jemi bashkë me Bacën në

vuajtje të dënimit në Llogorin e Stara Gradishkës, në Kroaci. Siç, me të drejtë e pohuan Vladimir Sheks, Stipe Mesiq, dr. Marko Veselica dhe Gjuro Perica, patriotë nacionalistë kroatë, të dënuar me burgime të gjata me të cilët Baca Adem dhe ne ishim bashkë në ato llogore persekutuese për të dënuarit politikë, baca Adem ishte autoritet suprem njerëzor, kombëtar, politik dhe moral për shqiptarët e dënuar politikisht, por edhe për vepra të tjera sikur që edhe për të burgosurit politikë kroatë. Ata me të drejtë e thanë se Baca Adem ishte një nacionalist i bindur, siç e kam thënë tërë kohën që ishte në gjendje të bëjë çdo gjë që kërkohej për popullim shqiptar mirëpo, në të njëjtën kohë, kur ndonjë popull rrezikohej sikur shqiptarët, menjëherë, në përkrahje, deklarohet si pjesëtar i atij populli të rrezikuar! Kush mund ta bëjë këtë, ndonëse e sulmuan vazhdimisht, përveç Bacës Adem që kishte vetëdije superiore njerëzore, kombëtare, politike dhe morale! Askush, pa asnjë dyshim! Ish të burgosurit politikë që janë në Grupin Baca Adem nuk iu ndanë kurrë Bacës Adem, deri kur kaloi në përjetësi. Edhe tash e ruajnë dhe kultivojnë frymën e Bacës Adem, sikur të ishim bashkë me të. Në Grupin Baca Adem jemi, dr. Haki Gashi, Tahir Hani, Nuh Ahmeti, Elmi Reçica, Avdullah Dërguti, unë dhe disa të burgosur të tjerë që do të bashkëngjiten. Pikërisht dr. Haki Gashi na dërgoi një tekst prononcimi ku, Jusuf Buxhovi, historian kosovar, thotë: "Demaçi ka qenë poli lindor. Programi i tij nuk ka qenë kombëtar. Programi i tij ishte ideologjik, koncept rus. Demaçi ishte në anën prosovjetike..." (Rrojum TV, Kanal 10, 25 shkurt 2021). Tash, ta shohim kush e thotë këtë dhe kush na qenka ky Jusuf Buxha apo Jovan Guxha! Sa isha i izoluar në Burgun e Mostarit me Rexhep Malën, i papërsëritshëm është Rexha, në planin kombëtar, me Skender Kastratin, intelektual me integritet të lartë njerëzor, kombëtar, politik dhe moral, me Agim Sylejmanin, që ndonëse ishte në moshë të re, ishte i pathyeshëm dhe i pakthyeshëm kombëtarisht, më ra në dorë romani "Shënimet e Gjon Nikollë Kazazit", që ma dërgoi gruaja ime, Fexhrije Shala-Bilalli, e burgosur politike dhe shumë e keqtrajtuar, e cila, ndonëse nuk dinte a do të dal gjallë nga

burgu, më priti tërë kohën sa isha në vuajtje të dënimit. Këtë sakrificë mund ta bëjnë vetëm gratë shqiptare që e ngritën kombin shqiptar dhe ishin dhe mbetën themel i shtetit shqiptar. Më bëri përshtypje ky roman sepse, në atë kohë edhe nuk kishim ndonjë roman në gjuhën shqipe që ia vlente dhe që e kalon censurën rigoroze të burgut, derisa binte në duar të burgosurve politikë. Çuditërisht, romanin e Jusuf Buxhovit ma dhanë pa e bërë asnjë kontroll, që nënkupton se nuk ka qenë në listën e romaneve të ndaluara. Pasi u dënova, për herë të dytë, në Gjyqin Ushtarak në Zagreb, me 12 vjet burgim, më dërguan në Llogorin e Lepogllavës për të më mbajtur, kryesisht, ose në vetmi, ose në izolim. Madje për 18 muaj më mbajtën në Burgun e vjetër, nga koha e Austro-Hungarisë, vetëm me dr. Marko Veselica. Ai ishte emër i njohur, unë emër i panjohur. I tërë kati i parë ishte për të, kurse kati i dytë ishte për mua. Nuk kishte të burgosur të tjerë, ndonëse kishte kapacitet për 150-200 vende. Mund të mendoni se kemi bërë shtatë palë qejfe në atë hapësirë por, më duhet ta sqaroj se hapësira ime, sikur edhe e dr. Marko Veselices, ishte dhoma ku qëndronim 24 orë të mbyllur, pa tualet dhe pa ujë brenda. I kishim vetë dy orë për ajrim brenda 24 orëve, kurse nevojën e kryenim në një uturak, kibëll të ndryshkur metalike, mbase e vitit 1945 të cilën e zbraznim një herë brenda 24 orëve në tualetin e burgut, në fund të korridorit të gjatë. Gjatë kohës sa isha me të burgosur të tjerë rrija me Remzi Ademajn, nga Zhuri, patriot i madh i cili punonte dhe vepronte në Gjermani. Ua thoshte këngëve patriotike që i kishte mësuar në Zhur dhe në Gjermani e që e dëgjonim me shumë pasion dhe përkushtim. Më tregoi se si e kishin burgosur në kufirin Slloveni - Itali duke bërë përpjekje ta kalojë ilegalisht një anëtar të familjes Gërvalla. M'u shtua interesimi se ku e njihje familjen Gërvalla, ani pse ata, bashkë me Kadri Zekën, për aktivitet patriotik i kishte ekzekutuar UDB-a jugosllave, apo shërbimi për ekzekutime politike që udhëhiqej nga Stane Dollanc. Jusuf Gërvallën e mbaja mend sa ishte student në Prishtinë ku, çdo mbrëmje luante me kitarë duke kënduar këngë të lehta, serenata korçare, me përmbajtje patriotike. Edhe unë banoja afër por, në moshën që e kisha, nuk e kuptoja se kush, në fakt, ishte Jusuf Gërvalla. Remzi

Ademaj, "komandant Petriti", gjatë luftës çlirimtare u vra, në rrethana ende të pasqaruara, duke rënë në një pritë. Më tregoi se kishte bashkëpunuar ngushtë me vëllezërit Gërvalla dhe, çdoherë kur fliste për ta, sytë i mbusheshin me lot. Remzi Ademaj në atëkohë e implikonte historianin kosovar, tash "vlerësuesin" e Bacës Adem në ekzekutimin e patriotëve të pashembullt, Jusuf dhe Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka sikur që thoshte se po ky historian merrte pjesë në çdo aktivitet të diasporës shqiptare, ndonëse ishte pjesë e stafit konsullar jugosllav. Edhe në shumë media është përfolur e kaluara, asnjëherë e sqaruar e Jusuf Buxhovit, me dyshime të rënda se i ka shërbyer regjimit jugosllav, si pjesë e pandashme e mendësisë dhe orientimit sllavo-rus, pa asnjë dyshim, në dëm të shqiptarëve! Po i njëjti ishte ndër themeluesit e LDK-së e që flitej se Rrahman Morina kishte dhënë dritë të gjelbër për themelimin, me arsytim se në këtë mënyrë e parandalojmë themelimin e një partie që do të kishte kërkesa, qëndrime dhe veprime radikale. Mund edhe të mos pajtoheni me qëndrimin politik të Bacës Adem, mund të thoni se në situata të caktuara mund të ketë pasur qëndrime dhe veprime të nxituara dhe gjëra të tjera por, të thoni se Adem Demaçi nuk ka pasur program kombëtar, se ka qenë poli lindor, pro rus dhe jashtëqijtë të tjera që ia atribuon Jusuf Buxha, alias Jovan Guxha, është jo vetëm jokorrekte dhe jonjerëzore, por është aso çmendurie që as i çmenduri më i madh nuk e beson. Derisa shovinistët serbë, duke filluar nga Aleksandar Ranković, Millovan Gjillas e deri te kryekrimineli Tito, e kanë vlerësuar Adem Demaçin nacionalist të papërmirësueshëm, të pandreqshëm dhe, për këtë e kanë prangosur thuaja 30 vjet, një ish-besnik i ish-regjimit e thotë të kundërtën. Duket se kur ky farë historiani e ka dhënë këtë vlerësim duke i ngatërruar programet, nuk e ka lexuar fare programin e Bacës ndërsa i është referuar programit të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë së cilës me aq përkushtim dhe besnikëri i ka shërbyer e që po e bën edhe tani. Realisht, të thuash se Adem Demaçi nuk ka pasur program kombëtar, kur e tërë jeta e tij, veprimtaria dhe përcaktimi ka qenë histori e ecjes dhe zhvillimit kombëtar është njëjtë sikur të thuash se

Zoti nuk e ka dërguar peygamberin Muhamet për ta interpretuar Kuranin dhe për ta përhapur besimin islam, por se e paska dërguar me Manifestin e Partisë Komuniste për ta përhapur ateizmin! Realisht, përjashtuar disa raste, pjesa dërrmuese e historianëve "kombëtarë" në Kosovë i kanë shërbyer regjimit jugosllav dhe ka bërë përpjekje ta mjegullojnë historinë kombëtare duke e zëvendësuar me historinë e Rankoviçit, Ivo Andriçit, Ilija Garashaninit dhe kriminelit Broz.

Jusuf Buxhovi, para se të merret me "rusin" dhe "sovjetin", Adem Demaçi, duhet ta heqë mjegullën nga e kaluara e tij duke dhënë sqarime për ekzekutimin politik të vëllezërve Gërvalla, Kadri Zekës dhe shumë patriotëve shqiptarë që kanë vepruar jashtë. Jusuf Buxhovi është në nivel intelektual, moral, kombëtar, njerëzor dhe politik kur e bën vlerësimin e Fadil Hoxhës, Ali Shukrisë, Sinan Hasanit, Kolë Shirokës dhe të ngjashmëve sepse është ngjizur, rritur dhe zhvilluar në folenë e tyre e që ka shërbyer si furrik për mbajtje të temperaturës optimale të prapancave të lartpërmendur, patriotëve të shquar të çështjes jugosllave dhe serbe.

Po të kishim mundësi t'i hapin dosjet tona nga e kaluara, ndoshta do të krenoheshim me të kaluarën e Cufës por, pasi Jusufi e ka të qartë se nuk mund të kemi qasje në ato dosje, që e mbrojnë, pa asnjë dyshim, atëherë, duke i fshehur këmbët si një gjarpër helmues, godet personalitetin më të shquar të historisë së re të popullit shqiptar, Bacën Adem Demaçi dhe, në këtë mënyrë, edhe neve që kemi shkruar pas Bacës e që edhe sot e kemi alfa dhe omega në aspektin kombëtar.

Grupi Baca Adem do të rritet me anëtarë të rinj, fëmijët tanë, nipa dhe mbesa për ta mësuar historinë e vërtetë kombëtare dhe për ta demantuar historinë e Jusuf Buxhovit e do jusefave të tjerë, derisa të krijohen kushtet që historianët e vërtetë, ta shkruajnë historinë e vërtetë. E që tani nuk e kemi, as në Kosovë e as në Shqipëri. Deri atëherë, ne jetojmë me historinë tonë për të cilën një çikë kemi kontribuar me vuajtjet tona dhe të familjeve tona, si pjesa e vërtetë e popullit shqiptar dhe me historinë e Jusufit që, në thelb, ka proveniencë sllave, atyre iu ka shërbyer në kohën kur "rusi", "sovjeti" dhe "antikombëtar", Adem Demaçi, kalbej në llogoret e urdhërdhënësve të këtij historiani gjatë thujta 30 vjetëve. Respekt dhe i përjetshëm qoftë kujtimi për veprën, sakrificën, qëndresën dhe kuptimin e fjalës liri dhe Bashkim Kombëtar, Baca Adem Demaçi!

BQK-ja e gatshme të ndihmojë për tejkalimin e gjendjes së krijuar nga pandemia

EPOKA E RE | Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 4 MARS - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka mbajtur të enjten takime me përfaqësues të bizneseve, të bankave komerciale dhe me drejtues të Fondit Kosovar për Garantimin e Kredive, me të cilët Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka krijuar një partneritet mjaft efektiv në mbështetje të ekonomisë së vendit gjatë kësaj periudhe jo të lehtë.

Ai ka thënë se BQK-ja së bashku me përfaqësuesit e bizneseve dhe bankat komerciale që operojnë në vend, falë këtij bashkëpunimi të ngushtë, kanë arritur t'i identifikojnë me kohë nevojat që kishte biznesi dhe qytetarët për t'ua përballuar më lehtë vështirësitë që rrodhën nga kriza pandemike. "Bazuar në këto nevoja, reaguam me kohë në lehtësimin e barrës së pagesës së kësteve kreditore për huamarrësit, duke bërë kështu që të zvogëlohen pasojat ekonomike të kësaj krize në

vendin tonë. Sidoqoftë, vështirësitë që ka shkaktuar kjo krizë ende po vazhdojnë të jenë të pranishme në ekonominë tonë dhe varësisht nga zhvillimet e lidhura me masat e mundshme kufizuese, bizneset mund të vazhdojnë të ballafaqohen me vështirësi të ngjashme edhe gjatë periudhës në vijim", ka thënë Mehmeti.

Ai ka theksuar se një ndër shtyllat kryesore të planit të rimëkëmbjes ekonomike, mbështetet pikërisht në lehtësimin e qasjes në financa përmes shfrytëzimit të skemës për garantimin e kredive, që ofrohet nga Fondi Kosovar për Garantimin e Kredive. "Ne e shfrytëzuam këtë takim për të diskutuar rreth efektivitetit të këtij programi të garantimit të kredive për t'i mbështetur ata që kanë nevojë që të përfitojnë nga ky program. Me këtë rast, potencuam rëndësinë që FKGK-ja ta zbatojë në shkallë sa më të lartë misionin e saj në lehtësimin e qasjes në financa të shtresave apo sektorëve me qasje të vështirësuar në financa, duke u lehtësuar qasjen në



financim bankar posaçërisht atyre që kanë vështirësi ta sigurojnë atë në mënyrë të pavarur", është shprehur ai, duke theksuar se: "Ne konsiderojmë se masat rregulatore të BQK-së për trajtimin e kredive të garantuara nga FKGK si asete pa rrezik për bankat, të cilat paraqesin një lehtësim shumë të rëndësishëm për sa iu përket kërkesave rregulatore për kapital ndaj bankave, si dhe mbulesa e tarifës garantuese nga Qeveria e Kosovës, paraqesin lehtësime

shumë të rëndësishme të cilat konsiderojmë se do të reflektojnë në kushte më të favorshme nga ana e institucioneve kredidhënëse për kreditë e garantuara", ka thënë guvernatori Mehmeti. Ai ka shtuar se BQK-ja mbetet e përkushtuar që ky partneritet të fuqizohet edhe më tutje përmes komunikimit të vazhdueshëm dhe harmonizimit të politikave, në mënyrë që ato të jenë sa më efektive në mbështetje të rimëkëmbjes dhe zhvillimit të ekonomisë së vendit.

Dogana arrin 10 për qind më shumë të hyra sesa dy muajt e parë të vitit të kaluar

PRISHTINË, 4 MARS (ER) - Dogana e Kosovës për dy muajt e parë të këtij viti ka arritur të inkasojë afër 167 milionë euro apo 10 për qind më shumë të hyra krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Udhëheqësi i Drejtorisë së Zbatimit të Ligjit në këtë institucion, Bashkim Arifi, në një konferencë për media ka thënë se projekcioni i të hyrave për vitin 2021 është rreth 1.2 miliard euro, i cili edhe mund të arrihet nëse vazhdohet me trendin e dy muajve të parë të këtij viti. "Gjatë periudhës raportuese për këta dy muajt e parë të vitit të hyrat e përgjithshme të inkasuara nga Dogana e Kosovës në total kanë



arritur shumën afër 167 milionë euro që, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, është afër 10 për qind më shumë. Do të thotë, rreth 14.6 milionë euro më shumë se

vitin e kaluar. Kur kihet parasysh fakti se këta dy muajt të vitit të kaluar nuk kanë qenë muajt pandemikë, kushtimisht po e them për shkak se ende nuk kemi pasur masa kufizuese

anti-Covid, kjo është një befasi e këndshme për buxhetin e Kosovës në të cilin kemi arritur t'i rrisim të hyrat për këta dy muajt", ka thënë Arifi.

Ai ka thënë se ky rezultat është arritur falë performancës të mirë të stafit të Doganës së Kosovës, operativës në inkasimin e të hyrave, si dhe veçmas angazhimi në luftimin e evazionit fiskal, kontrabandës dhe informalitetit.

Ndërkaq udhëheqësi i Departamentit Kërkimor, Driton Azemi, ka treguar se Dogana e Kosovës ka kryer rreth 1 070 ndalesa rrugore, duke shtuar se janë duke u hetuar 11 zyrtarë të Doganës për keqpërdorim të detyrës zyrtare.

KEDS-i dhuron 50 kompjuterë për SOS Fshatrat e Fëmijëve

PRISHTINË, 4 MARS (ER) - Kompania Kosovare për Distribuim të Energjisë Elektrike (KEDS) ka bërë shpërndarjen e një kontingjenti prej 50 kompjuterëve për fëmijët e familjeve të SOS Fshatrave. Siç u tha, ky donacion është pjesë e përkushtimit të vazhdueshëm të KEDS-it për përgjegjësinë shoqërore të korporatës, e cila deri më sot ka dhuruar mbi 150 kompjuterë për institucionet arsimore gjithandej vendit.

Sipas KEDS-it, kjo nuk është hera e parë që ata kanë dhuruar pajisje për këtë institucion, pasi që në dhjetor të vitit të kaluar kompania kishte pajisur fëmijët e SOS fshatrave me dhjetëra tabletë. Më tutje, KEDS-i ka theksuar se iniciativa të tilla do të ketë edhe në të ardhmen me qëllim që fëmijëve t'u krijohen mundësitë që njohuritë teorike t'i gërshetojnë me ato praktike përmes kabineteve të cilat do të krijohen aty ku është nevojta.



Pse Kosova duhet ta ketë ambasadën në Jerusalem?

Nëse deri më tani Kosova është shantazhuar me lloj-lloj vetosh dhe lloj-lloj qëndrimesh hermafrodite nga ana e OKB-së dhe BE-së, duke favorizuar hapur pozicionin e Beogradit kundrejt Prishtinës në tryezat e dialogut, atëherë me çfarë të drejte kërkohet me insistim nga Kosova që ambasadën e saj mos ta hapë në Jerusalem. Kosova iu ka shumë borxh miqve ndërkombëtarë, por më së tepërmi atyre që ishin sponsorë të drejtpërdrejtë të çlirimit të saj. Çdokush në BE dhe në OKB që nuk e kupton këtë sensibilitet të Kosovës, gabon rëndë



Nga Mehmet PRISHTINA

Ende pa filluar punën Qeveria e re e Kosovës, para saj del një sfidë jo e vogël, që lidhet sërish me politikën e jashtme. Paradoksalisht, politika e jashtme po bëhet përcaktuese edhe e zhvillimeve të brendshme si dhe e qëndrueshmërisë së qeverive. Pritet kështu të jetë edhe në të ardhmen, pasi që nga kryeministri i ardhshëm, Albin Kurti, pritjet të japë përgjigje definitive mbi hapjen e Ambasadës së Kosovës në Jerusalem. Kurti ndodhet në mes të dy përgjigjeve: jo dhe po dhe varësisht se kujt do t'i thotë jo dhe kujt po, do të varet edhe fati i tij si politikan dhe i qeverisë që ai do ta drejtojë.

Megjithëse situata duket paksa e komplikuar, në realitet ajo nuk është pa shtegdalje, për arsye se Kurti po e trashëgon një situatë që ndërlidhet me çështjen e hapjes së Ambasadës së Kosovës në Jerusalem, siç kërkohet nga Marrëveshja e 4 shtatorit 2020 në Uashington, kështu që ai fare nuk gabon nëse i përmbahet kësaj marrëveshjeje. Se ku do të vendoset Ambasada e Kosovës në Izrael, sipas protokolleve dhe ligjeve diplomatike, i takon shtetit pritës dhe jo Kosovës, prandaj edhe në këtë aspekt Albin Kurti i ka duart e zgjidhura dhe nuk ka shumë hapësirë për hezitime.

Ditë më parë kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ia ka kthyer letrën kryeministrit izraelit, Benjamin Netanyahu, i

cili disa ditë më parë e uroi për fitoren në zgjedhjet e 14 shkurtit. Në këtë letër, Kurti shkruan se e mirëpret faktin që marrëdhëniet mes dy popujve janë shndërruar në raporte diplomatike mes dy shteteve. "E shoh këtë si një mundësi për ta themeluar dhe fuqizuar bashkëpunimin tonë politik, ekonomik dhe kulturor", thuhet në letrën dërguar kryeministrit izraelit. "Kombi ynë ka qenë historikisht respektues ndaj komunitetit çifut. Si kryeministër i ardhshëm i Republikës së Kosovës do ta kem kënaqësinë që t'i adresoj çështjet relevante të komunitetit çifut dhe trashëgimisë së tij në vendin tonë", thuhet në letër. Kurti e falënderon Netanyahu për ftesën që ta vizitojë Izraelin, premtan se do ta bëjë këtë, por

nuk saktëson kohën e vizitës. "Faleminderit që më ftuat për ta vizituar vendin tuaj miqësor, gjë që do ta bëj në një kohë të përshtatshme për të dyja palët", thuhet në letrën e Kurtit.

Një letër të ngjashme si përgjigje, Albin Kurti, i ka shkruar edhe presidentit të Turqisë, Rexhep Tajip Erodogan.

Kurti e ka falënderuar presidentin turk për letrën e urimit për fitoren e Lëvizjes Vetëvendosje në zgjedhjet parlamentare të 14 shkurtit.

Kurti shkruan se në këto zgjedhje kosovarët kanë vendosur "ta ndryshojnë rrënjësisht të ardhmen e tyre". Ai thekson se shqiptarët në Turqi dhe turqit në Kosovë janë urë miqësie midis dy vendeve. "Më 14 shkurt të këtij viti, përmes zgjedhjeve demokratike, qytetarët e Republikës së Kosovës vendosën të ndryshojnë rrënjësisht të ardhmen e tyre. Shqiptarët në Turqi dhe turqit në Kosovë janë një urë miqësie midis vendeve tona. Unë e vlerësoj kontributin e banorëve turq në Kosovë dhe ata do të vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm edhe gjatë qeverisjes time", shkruhet në letër.

Kurti shkruan se qytetarët e Kosovës janë falënderues për ndihmën që kanë dhënë shteti dhe populli turk në kohët më të vështira.

Në të dy letrat Albin Kurti, përmes një gjuhe fleksibile

diplomatike e ka larguar mundësinë e keqkuptimit nga komunikimet ndërshtetërore dhe në këtë mënyrë i jep hapësirë vetes që të vendos brenda një harku të caktuar kohor pa qenë i detyruar të ndodhet nën efektet e ndonjë presioni.

Kosova ende nuk është anëtare fuqplotë e OKB-së, kurse BE ende nuk e ka njohur zyrtarisht pavarësinë e Kosovës. Madje në komunikimet zyrtare, siç ishte rasti me hartën e Lajçakut, ku Kosova figuronte si pjesë e Serbisë, BE ka një qëndrim hermafrodit kundrejt Kosovës.

Me fjalë të tjera, nga Kosova kërkohet t'iu përmbahet rregullave ndërkombëtare pa qenë anëtare e mekanizmave ndërkombëtarë, përfshi edhe OKB-në. Është e vërtetë se Rezoluta e KS të KB obligon shtetet që t'i përmbahen parimit sipas të cilit Tel Avivi mbetet kryeqyteti i Izraelit, ndërkohë që statusi i Jerusalemit mbetet të zgjidhet në mes të dy popujve sipas një marrëveshjeje dypalëshe.

Mirëpo, në anën tjetër, Kosova nuk është anëtare e OKB-së, për t'iu përmbajtur kësaj rezolute, dhe deri më tani ajo është refuzuar me arsyetimet dhe kërcënimet për VETO nga Rusia dhe Kina.

Nëse deri më tani Kosova është shantazhuar me lloj-lloj vetosh dhe lloj-lloj qëndrimesh hermafrodite, duke favorizuar hapur pozicionin e Beogradit kundrejt Prishtinës në tryezat e

dialogut, atëherë me çfarë të drejte kërkohet me insistim nga Kosova që ambasadën e saj mos ta hapë në Jerusalem.

Kosova është shtet i pavarur, i njohur ndërkombëtarisht nga më shumë se 100 shtete, mirëpo kjo nuk i ka mjaftuar BE-së dhe OKB-së ta mbajë atë në listën e pritjes si në aspektin e liberalizimit të vizave, ashtu edhe në anëtarësimin në disa organizata ndërkombëtare, ku Serbia me lobimin e saj, kurse BE dhe OKB me heshtjen e tyre, e kanë dëmtuar dukshëm fuqizimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës.

Qeveria e ardhshme e Kosovës duhet t'i ruajë miqtë e saj të deritanishëm ndërkombëtarë dhe mundësisht t'i shtojë edhe më tepër ata. Mirëpo miqësitë nuk mbahen me kushtëzime dhe shantazhime, dhe më së paku me ultimatumë në stilin "nëse nuk je me mua, je kundër meje"! Në rastin konkret hapësirë për manovrimë nuk ka gjithaq dhe udhëheqja e re e Kosovës duhet ta ndjekë logjikën e zhvillimit të ngjarjeve të deritanishme, të cilat kanë qenë jetike për të ardhmen e shtetit të ri. Kjo logjikë thotë se Kosova u ka shumë borxh miqve ndërkombëtarë, por më së tepërmi atyre që ishin sponsorë të drejtpërdrejtë të çlirimit të saj. Çdokush në BE dhe OKB që nuk e kupton këtë sensibilitet të Kosovës, gabon rëndë dhe më shumë gabon nëse nga Kosova kërkohet shumë më shumë sesa që i jepet në këmbim asaj diçka.

Prishtinë, 4 mars 2021



“Traktati i tolerancës”: Një himn kundër fanatizmit fetar



“Toleranca dhe harmonia fetare, nuk i ka bërë keq askujt, është mostoleranca ajo që ka shkaktuar këtë kasaphanë në të cilën jemi bashkëjetues”. Kështu shkruan Volteri më vitin 1763 në librin “Traktat mbi tolerancën”, një nga librat më të mirë të shkruar ndonjëherë për besimin fetar dhe raportin mes fesë dhe individit.

Nga: Luan RAMA

Në qendër të rrëfimit të Volterit është historia e Zhan Kalasit, një tregtar protestant i cili akuzohet për vrasjen e djalit të tij, pasi ai dëshironte të ndryshonte besimin fetar duke u kthyer në katolik. Ngjarja ku bazohet libri ka ndodhur në Francë, në një zonë të Tuluzës. I bindur për pafajësinë e të atit, Volteri e merr sërish çështjen në dorë duke shkruar këtë traktat mbi tolerancën. Aty ai paraqet të gjitha gjasat e rreme dhe mangësitë e padisë së procesit kundër plakut Kalas dhe shpjegon se si paragjykimi kundër protestantëve shtyu njerëzit dhe gjykatësit të merrnin vendimin më të rëndë: dënimin me vdekje.

Gjykata e Tuluzës, më 9 mars të vitit 1762, megjithëse ky nuk ishte një krim i kryer prej tij, pasi i biri kishte vlarë veten. Torturat ndaj Kalasit e bënë atë të pranonte krimin.

Volteri e merr këtë histori të ndodhur në Tuluzë për ta kthyer në një himn të akuzave që bëheshin në emër të fesë, dhe se si kjo e fundit shpesh keqinterpretohet duke u

akuzuar dhe për krime. “Atje ku rreziku mbart edhe anë të mira, frika davaritet dhe mëshira fashitet. Por, kur një baba i pafajshëm bëhet pre e gabimit, pasionit, apo fanatizmit; kur i akuzuari ka për mbrojtje vetëm virtytin; kur nëse dënojnë dikë, gjykatësit e fatit të tij ia hedhin pa u lagur dhe ky dënim quhet thjesht një gabim; kur ia shkojnë kokën në satër dikujt, por nuk u hyn gjemb në këmbë, atëherë zëri i popullit çan qiejt, gjithkush kërkon të ruajë kokën, duket që askush nuk është i sigurt para një gjykate të ngritur për të mbrojtur jetën e qytetarëve dhe të gjithë zërat së bashku thërrasin për të kërkuar shpagim. Në këtë mesele të çuditshme, bëhej fjalë për fe, vetëvrasje dhe atëvrasje. Çështja ishte nëse babai dhe nëna kishin mbytur birin e tyre për hir të Zotit, nëse vëllai kishte mbytur vëllain, nëse miku kishte mbytur mikun, apo nëse ishte edhe faji i gjykatësve që kishin shpënë mbi rrotën e vdekjes një baba të pafajshëm, apo që i kishin falur jetën një nëne, një vëllai, një miku fajtor”, shkruan Volter në kapitullin e parë të librit.

I konsideruar gjithnjë si një nga

traktatet më të mira të shkruara ndonjëherë për besimin dhe mënyrën sesi duhet ta shohim atë, ky libër është kthyer këto kohë në një nga librat më të shitur në Francë pas ngjarjeve në revistën satirike “Charlie Hebdo”, ku humbën jetën 20 vetë. Redaktori i “Charlie Hebdo”, Stephane Charbonnier, i cili humbi jetën gjatë sulmit fatal, kishte shkruar dy libra bazuar në historinë e Volterit. Më shumë se dy shekuj jetë, libri i Volterit vazhdon t’i flasë kohës dhe shoqërisë së sotme, duke apeluar mbi rëndësinë e tolerancës fetare. Shtëpia botuese “Saras” e ka botuar në shqip këtë libër, duke e futur gjuhën shqipe në hartën e gjuhëve në të cilat ka folur ky libër. I përkthyer nga Fari Laçka, libri i cili mund të quhet dhe një ese e gjatë filozofike, nuk tregon thjesht një histori, por të bën të lexosh përmes saj. Duket sikur Volteri e parashikon të ardhmen, atë çfarë po ndodh sot në emër të fesë, trazirat në Lindjen e Mesme, apo vrasjet në emër të ISIS-it.


Në paragrafin e parë të librit ai shkruan se “kjo është jo vetëm një ‘nga ngjarjet më të pazakonta që meritojnë vëmendjen e brezave të sotëm dhe atyre të ardhshëm’, por edhe një mësim i mirë që duhet të nxjerrin të gjitha kombet e shoqëritë e sotme”. Traktat mbi tolerancën është ese e shkruar në vitin 1763 nga shkrimtari dhe filozofi i shquar francez, François Marie Arouet, ose siç njihet ndryshe, Volter. Lindur më 21 nëntor të vitit 1694, ai ishte një nga ata filozofë të

shekullit të Përndritjeve, një figurë shumë komplekse që u dallua për mprehtësinë, kritikën e ashpra drejtuar fesë, në veçanti asaj katolike, mbrojtjen e lirinë e besimit, të shprehjes, ndarjen e shtetit nga kisha dhe luftoi sidomos kundër dogmave fetare dhe mostolerancës. Shekulli i tetëmbëdhjetë kur jetoi Volteri, është kohë ndryshimesh të mëdha në shumë aspekte të jetës, veçanërisht në shkencë e filozofi dhe siç thotë ky shkrimtar ‘në shpirtit e mendjet e njerëzve ka ndodhur një revolucion’...

“Drita po përhapet nga të gjitha anët”, shkruan ai në vitin 1765. Por, edhe në këtë atmosferë të re ku ishte futur shoqëria njerëzore, siç shprehet ai përsëri “te njeriu ka mbetur ende zgjyra e fanatizmit”. Ndaj dhe ky shkrimtar i jashtëzakonshëm bëhet pishtar i lirisë dhe armik i përbetuar i paragjykimeve, fanatizmave, dogmave dhe fesë, por asaj feje që në disa periudha e zhyti njerëzimin në padituri dhe rrënim, pavarësisht se, me sa kuptojmë nga ato që shkruan, vetë Volteri e pranon se Zoti ekziston. Kjo ese është një kampion e cila lajmëron se fanatizmi i ka rrënjët ende të forta dhe vështirë se mund të shkulet nga mendja dhe shpirti i disa njerëzve, të cilët besojnë te feja ose verbërisht, ose qëllimthi për të përfituar prej saj. Mjeshtërinë e tij e kanë vlerësuar të gjithë ata që kanë lexuar edhe vepra të tjera të njohura, apo të panjohura. Mjafton të përmendim këtu Zagigun, apo Kandidin, dy pamflete të fuqishme kundër

dhunës, urrejtjes, vrasjeve, luftërave e gjëmave të historisë, shtypjes dhe zvetënitimit të genies njerëzore.

Historia e Zhan Kalasit është kthyer në një histori simbol të krimeve në emër të fanatizmit fetar. Si njohës i mirë i çështjeve fetare dhe ligjore, gjatë gjithë esesë shkrimtari sjell fakte mbresëlënëse nga epoka, shoqëri dhe bashkësi të ndryshme fetare dhe duke i gërshtuar me njëra-tjetrën, ai përfundon librin pikërisht aty ku ka zanafillën, rehabilitimi i figurës së plakut Kalas si nder i tolerancës dhe turpi i mostolerancës, një tregues i qartë se deri ku mund ta shpjerë fanatizmi mendjen dhe shpirtin e njeriut. Volteri është një nga ata luftëtarë të cilin arsyeja e udhëheq gjithmonë drejt qëllimit që i ka vënë vetes: të jetë avokati mbrojtës i dinjitetit njerëzor dhe armik i përbetuar i çfarëdo lloj shtypjeje, tiranie e fanatizmi. Ashtu si në shumë vepra të tjera, ironia e tij shumë e hollë dhe therëse, nxjerr më në pah paradokset njerëzore të ndikuara nga rryma e teori të ndryshme fetare. Nuk ngurron ky shkrimtar i guximshëm të kritikojë edhe figura të njohura fetare, në shënjestrën e të cilit vihen edhe vetë ‘mëkëmbësit e Zotit mbi tokë’, papët e Romës, duke treguar se vetëm duke pasur guximin t’u kundërvihemi dukurive të tilla, atëherë do të mund njeriu që ta shndërrojë shoqërinë dhe vlerat e krijuara deri më sot në një qytetërim më fisnik, më të dhembshur e fundja, thjesht më njerëzor.



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Tahiri: Jam i lumtur që e sigurova normën olimpike 'Pekin 2022'

"Jam shumë i lumtur me garën e sotme. Kam përmirësuar rezultatin për dallim nga e mërkura (i 29-ti) dhe kam marrë 82.24 pikë të FIS-it, që është rezultati dukshëm më i mirë për Kosovën në dy sezonet e fundit në ndonjë disiplinë", ka thënë Tahiri

PRISHTINË, 4 MARS - Albin Tahiri ka kompletuar rezultatet e nevojshme për normën olimpike për Lojërat Olimpike Dimërore "Pekin 2022", disiplina e sllallomit të madh në skijimin alpin. Skitari i Kosovës doli i 23-ti në garën e mbajtur të enjten në Maribor të Sllovenisë. Tahiri përfundoi të dyja lëshimet me kohë 2:16.76 minuta, për të fituar 82.24 pikë të Federatës Ndërkombëtare të Skitarisë (FIS). Në garë morën pjesë 50 garues, ku 10 prej tyre nuk

përfunduan njërin nga dy lëshimet.

"Jam shumë i lumtur me garën e sotme. Kam përmirësuar rezultatin për dallim nga e mërkura (i 29-ti) dhe kam marrë 82.24 pikë të FIS-it, që është rezultati dukshëm më i mirë për Kosovën në dy sezonet e fundit në ndonjë disiplinë", ka thënë Tahiri për faqen zyrtare të Komitetit Olimpik të Kosovës. "Tani e kam çuar në pesë numrin e rezultateve të nevojshme për normën

olimpike, të cilën tani e kam të arritur në sllalom të madh, për çka jam shumë i lumtur", ka shtuar 32-vjeçari. Albini do ta kërkojë normën olimpike edhe në sllalom dhe disiplinat e shpejta si: Super sllalom të madh, kombinim alpin dhe lëshim. Më herët, normën olimpike, por në disiplinën e sllallomit, e ka arritur Arbi Pupovci. Lojërat Olimpike Dimërore mbahen në Pekin të Kinës prej 4-20 shkurtit të vitit të ardhshëm.



Davidkovi largohet nga KB Peja, vjen Radoviqi



PEJË, 4 MARS - KB Peja ka njoftuar të enjten se trajneri Jordanco Davidkov është larguar nga klubi dhe se trajneri i ri do të jetë Dragan Radoviq. Për këto ndryshime në krye të shtabit teknik, klubi pejan brenda një ore ka njoftuar në faqen zyrtare

në "Facebook". "Jordanco Davidkov jep dorëheqje nga detyra e trajnerit pas humbjes ndaj Yllit. Kontrata është ndërprerë me marrëveshje të dyanshme dhe ne i urojmë shumë fat dhe sukses në të ardhmen", thuhet në njoftimin

e parë të KB Peja. Ndërsa në njoftimin pasues të klubit pejan thuhet: "Ne sot prezantojmë trajnerin e katërt për këtë sezon dhe ai është trajneri me përvojë dhe me trofe në basketbollin e Kosovës, i cili së fundmi udhëhoqi Prishtinën drejt

trofeut të Kupës. Dragan Radoviq do të jetë trajneri ynë i ri i cili, duke i ditur të gjitha problemet tona, ka vendosur që të na bashkohet dhe ta bëjmë një mbyllje sa më të suksesshme të sezonit. I urojmë shumë sukses dhe fat".

FFK-ja: Kuvendi i rregullt i punës mbahet më 8 prill

PRISHTINË, 4 MARS - Komiteti Ekzekutiv i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) mbajti mbledhjen e radhës, nën drejtimin e kryetarit Agim Ademi. Në mesin e shumë temave me rëndësi, KE analizoi garat e deritashme të stinorit pranveror duke konstatuar se, me gjithë disa lëshime të vogla, ka një ngritje të cilësisë sikur edhe një rivalitet të mirë të skuadrave në suaza të "fair-play"-t. KE analizoi edhe punën e deritashme të komisioneve dhe kërkoi nga to që të jenë në nivel të detyrave dhe syçelë në mënyrë që të kontribuojnë në mbarëvajtjen e garave. "KE po vazhdon përgatitjet që sa më parë ta instalojë sistemin VAR, që do të ishte një ndihmesë e

madhe për mbarëvajtjen e garave. Komiteti Ekzekutiv iu bënë thirrje edhe një herë klubeve dhe personave zyrtarë në ndeshje, që në përpikëri t'i zbatojnë masat e Udhëzimit të IKShPK-së për Covid-19. KE diskutoi edhe për përkrahje në zhvillimin e futbollit të femrave që do të reflektonte edhe në ngritjen e kombëtareve. Kështu që FFK-ja me një projekt që e ka miratuar edhe UEFA do ta vazhdojë mbështetjen e klubeve të femrave. KE shqyrtoi dhe miratoi raportin e auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare për vitin 2020. KE mori vendim që Kuvendi i Rregullt i Punës të mbahet më 8 prill 2021", thuhet në njoftimin e Federatës së Futbollit të Kosovës.



Aston Villa nuk heq dorë nga Rashica

BREMEN, 4 MARS - Aston Villa është duke kërkuar që të përforcohet në fazën e sulmit dhe Milot Rashica është sërish një prej objektivave kryesore. Repreruesi i Kosovës ishte i lidhur me një kalim te skuadra angleze në

verën e vitit të kaluar dhe në janar të këtij viti, por që kjo lëvizje nuk ndodhi. Sipas mediave angleze, Aston Villa është duke monitoruar 24-vjeçarin dhe mund të tentohet transferimi i tij gjatë afatit kalimtar të kësaj vere. Klubi anglez

është gati të paguajë deri në 25 milionë euro për futbollistin që mbron ngjyrat e Kosovës. Kontrata e futbollistit nga Vushtrria me Werder Bremenin është e vlefshme deri më 30 qershor të vitit 2022.



Vetteli: Dua ta mposhti Ferrarin

WARWICKSHIRE, 4 MARS - Aston Martin është njëvendëshja e katërt për Sebastian Vettelin në Formula 1, që pas gjashtë sezonesh vendosi të largohej nga Ferrari, ku nuk arriti të fitojë dot asnjë titull. Ndaj, për pilotin

gjerman, katër herë kampion bote në Formula 1, hakmarrja ndaj "kokëkuqes" duket se është një objektivi i paevitueshëm. "Si skuadër ne synojmë vendin e tretë në Formula 1. Kjo do të thotë që na duhet të mposhtim edhe Ferrarin.

Kjo do të ishte një kënaqësi për mua dhe për skuadrën që do ta arrinte objektin e saj. Që në garën e parë do të garoj për të mposhtur çdo makinë, përfshirë edhe Ferrarin", ka thënë Vettel. Aston Martin është prezantuar për fansat, një

makinë që do të jetë ngjyrë jeshile. "Mezi pres ta nis aventurën e re dhe t'i mësoj sekretet e kësaj makine. Përvoja e gjatë në Formula 1 do të më ndihmojë. Do të jetë një tjetër sezon i vështirë për të gjithë për shkak të pandemisë", ka shtuar Vettel.



Ymeri paralajmëron Ballkanin: Udhëtojmë për rezultat pozitiv

PRISHTINË, 4 MARS - Në fundjavë zhvillohet xhiron e 23-të e Superligës së Kosovës në futboll, që pritet të jetë shumë interesante duke i parë çiftet e skuadrave që do të përballen ndërmjet veti. Një e tillë pritet të zhvillohet në Suharekë, ku skuadra e Ballkanit e pret Drenicën. Ballkani është duke luftuar për titullin kampion, kurse skuadra e Drenicës për mbijetesë. Arion Ymeri, i cili ka folur për ndeshjen kundër Ballkanit, objektivi i klubit dhe për tifozët. Sipas Ymerit, dueli kundër Ballkanit është shumë i vështirë, por e kanë një përparësi pasi që skuadra nga Suhareka nuk është në formën më të mirë. "Dueli me Ballkanin do të jetë shumë i vështirë duke e pasur parasysh ekipin që kanë, mirëpo jemi përgatitur maksimalisht për këtë duel dhe do të japim maksimumin për të nxjerrë një rezultat pozitiv. Përparësi e vogël është që Ballkani nuk është duke kaluar në formën më të mirë, shpresoj që edhe kundër neve mos të jenë në formë", ka thënë



Ymeri për gazetën "Sheshi". Portieri i "kuqezinjve" ka folur edhe për objektivi kryesor të klubit këtë sezon. "Duke u bazuar në ekipin që kemi krijuar tash, besoj shumë që do ta sigurojmë mbijetesën. Mendoj që do shkojmë deri te vendi i pestë pasi që nuk jemi larg me pikë, do të jetë një luftë e fortë deri në fund. Objektivi kryesor është mbetja në Superligë", ka shtuar Ymeri. Për fundi, "gardiani" i Drenicës u ka premtuar tifozëve të klubit angazhim maksimal dhe se tifozët e meritojnë të gëzohen

me ndonjë trofe. "Tifozëve ju premtoj që do ta japim maksimumin nga i pari deri te i fundit që jemi në klub. Shpresoj që të kemi fat edhe në garën e Kupës dhe ta fitojmë, kjo do të ishte dhurata më e mirë për tifozët tanë, e meritojnë pasi i kemi në mbështetje gjithmonë, si në rezultatet pozitive ashtu edhe negative dhe për këtë dua t'i falënderoj", përfundoi Ymeri. Ballkani - Drenica zhvillohet sot (e premte) me fillim nga ora 13:00. Drenica zë vendin e nëntë në klasifikim me 24 pikë të grumbulluara.

Mposhten Lakersat dhe Utah Jazzi



REZULTATET

Philadelphia 76ers - Utah Jazz	131-123
Houston Rockets - Brooklyn Nets	114-132
Orlando Magic - Atlanta Hawks	112-115
Sacramento Kings - Los Angeles Lakers	123-120
Portland Trail Blazers - Golden State Warriors	108-106
Toronto Raptors - Detroit Pistons	105-129
Dallas Mavericks - Oklahoma City Thunder	87-78
New Orleans Pelicans - Chicago Bulls	124-128
Minnesota Timberwolves - Charlotte Hornets	102-135
Cleveland Cavaliers - Indiana Pacers	111-114

SACRAMENTO, 4 MARS - Tjetër disfatë për kryesuesit e Konferencës së Perëndimit në NBA. Është dashur koha shtesë për ta vendosur supersfidën në mes të Philadelphia 76ers dhe Utah Jazzit, e fituar nga të parët me rezultatin 131-123. Thuajse gjatë gjithë kohës së rregullt Jazz qëndroi në kryesim, madje shkoi edhe +13 pikë në periodën e dytë, por 76ers e ngushtoi diferencën duke e barazuar rezultatin në fund 118-118 falë një trespikëshi të Joel Embiid, protagonist absolut i sfidës me 40 pikë dhe plot 19 "rebounde". Në kohën shtesë u shfaq i papërbajtshëm Tobias

Harris, që realizoi 11 nga 13 pikët e tij, raporton "Supersport". Fitore bindëse në transfertë e Brooklyn Netsit 114-132 përballë Houston Rocketsit. U rikthye në shtëpi, por këtë radhë si kundërshtar, James Harden, autor i një "triple-double": 29 pikë, 14 asistime dhe 10 "rebounde". Në fakt, Rocketsi luajti një periodë të parë me nivel, por më pas gjithçka foli për Netsin, që krijoi shumë shpejt një diferencë të parikuperueshme pikësh për vendasit, që pësuan humbjen e 13-të radhazi. Dështuan në parketin e Sacramento Kings Los Angeles

Lakersi me rezultatin 123-120. E kuptueshme kjo disfatë e skuadrës kaliforniane në një mbërmeje ku nuk ishin të pranishëm mbi parket LeBron James, Anthony Davis, Marc Gasol dhe Alex Caruso. Megjithatë, Lakersi kryeson në pjesën e parë, por Kingsi e ktheu përballjen në limit në favorin e tij, falë gjuajtjeve të sakta të lira të Harrison Barnesit. Spikati në këtë takim Buddy Hield me 29 pikë. Sukses edhe për Detroit Pistonsin, që e pati të lehtë përballë Toronto Raptorsit, duke fituar me diferencë 129-105. Skuadra kanadeze, në fakt, ishte e detyruar ta luante këtë sfidë pa gjysmën e organikës. Shënuesi më i mirë i Pistonsit rezultoi Wayne Ellington me 25 pikë.

SHKURT

Sahiti transferohet në Kroaci

Futbollisti Suad Sahiti është lojtari më ri i Shibenikut, pasi ka nënshkruar një kontratë deri në vitin 2023. Sahiti së fundmi ishte aktivizuar në skuadrën boshnjake Zrinjski Mostar. 26-vjeçari do ta veshë fanellën me numrin 77 dhe pas shumë vitesh ai do të luajë së bashku me vëllanë e tij Emirin. Sahiti karrierën profesionale e filloi në Maqedoni, më saktësisht në Rabotnički, ku regjistroi 70 paraqitje, duke shënuar 8 gola dhe 6 asistime. Pas lojërave të shkëlqyera, ai u largua nga Rabotnicki, duke luajtur me klube si Skënderbeu, AE Larisa, Septemvri Sofia. Ai pastaj bëri karrierë te Ekstraklasa të Polonisë ku luajti për Wisla Plock. Sahiti është zhvilluar si futbollist në Kosovë duke luajtur në ekipe si Ramiz Sadiku e Hajvalia. Suadi e ka një paraqitje edhe me Përfaqësuesen e Kosovës.

Kessie: Milani nuk dorëzohet në garë për titull

Mesfushori Franck Kessie ishte hero i Milanit në ndeshjen kundër Udineses (1-1), pasi nga penalltia e shënoi golin e barazimit në minutën e shtatë të kohës shtesë. Kessie ka thënë se skuadra kuqezi nuk dorëzohet në garë për titull. "Objektivi i Milanit në fillim të sezonit ishte ai i rikthimit në Ligën e Kampionëve. Besoj se për këtë biem dakord të gjithë. Por, çështja është që ne nuk jemi dorëzuar as për titullin dhe për asgjë tjetër. Duam dhe do të vazhdojmë të luftojmë me të gjitha forcat deri në fund", ka thënë Kessie.

Ter Stegen: Synojmë të fitojmë trofe

Barcelona bëri një rikthim të jashtëzakonshëm në ndeshjen e dytë gjysmëfinale ndaj Sevilas në Kupën e Mbretit, duke fituar 3-2 me rezultat të përgjithshëm. Katalunasit avancuan në finale pasi arritën të fitonin 3-0 në vazhdimë ndaj Sevilas. Ter Stegen ishte një ndër lojtarët kryesor në fitoren e djeshme, pasi priti penalltinë e Lucas Ocampos. "Ishte një ndeshje shumë speciale dhe mentaliteti ka qenë thelbësor për këtë rikthim të madh. Ne dëshirojmë të fitojmë trofe. Kjo fitore ishte shumë e rëndësishme. Do të na ndihmojë shumë. Ishte sigurisht qëllimi ynë. Jemi të lumtur që kemi arritur në finale", ka thënë Ter Stegen.

Liverpool - RB Leipzig zhvillohet në 'Puskas Arena'

Ndeshja e kthimit e 1/8 finale të Ligës së Kampionëve, Liverpool - RB Leipzig, do të luhet në Budapest për shkak të kufizimeve të pandemisë në Gjermani dhe Angli, në lëvizjet e ndërprera mes këtyre dy vendeve prej variantit britanik të koronavirusit. UEFA ka zgjedhur këtë fushë asnjëse, ku skuadrat në fjalë u përballën edhe në "aktin" e parë të këtij raundi. Në të njëjtin stadium, "Puskas Arena", gjermanët do të përpiqen të "kthehen në jetë", duke e nisur nga disavantazhi 2-0 i sfidës së parë, vulosur më 16 shkurt në kryeqytetin hungarez.

Tevezi mohon se është pensionuar

Rreth dy javë më parë Carlos Tevez humbi të atin për shkak të infektimit me koronavirus. Për këtë arsye, 37-vjeçari ka munguar për një kohë relativisht të gjatë në stërvitjet e Boca Juniorsit, duke "ushqyer" zërat se kishte vendosur të tërhiqej përfundimisht nga futbollit. Në një reagim në rrjetet sociale, ish-sulmuesi i Manchester United, Manchester Cityt dhe Juventusit në Evropë, i ka hedhur poshtë këto raportime. "Për fat të keq, ka shumë njerëz që duhet të informohen më parë, por në vend që ta bëjnë këtë, shpërndajnë thashetheme keqdashëse në formë pyetjesh. E them këtë sepse po shkruajnë shumë gjëra në lidhje më të ardhmen time që nuk janë të vërteta", ka thënë Tevezi.



SHALLJE PËR VEND TË LIRË TË PUNËS

Titulli: Zyrtar i lartë i protokollit
Njësia : Kabineti i Guvernatorit
Niveli i gradës: 5
Raporton tek: Guvernatori

Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësi:

- Bën planifikimin, zhvillimin, menaxhimin dhe ekzekutimin e ngjarjeve kryesore të organizuara nga BQK-ja;
- Në pozitën e Zyrtarit të lartë të protokollit të BQK-së, siguron që protokollin të kuptohen dhe zbatohen në të gjitha takimet dhe ngjarjet e BQK-së;
- Zhvillon dhe zbaton politika, strategji, udhëzime dhe procedura në lidhje me menaxhimin protokollit të BQK-së;
- Jep këshilla për politikën profesionale për protokollin, ngjarjet dhe çështjet e logjistikës;
- Siguron udhëzime për stafin e lartë, përfshirë Guvernatorin, për vizita të nivelit të lartë dhe zyrtar, përfshirë zhvillimin e programit dhe protokollin e ngjarjeve;
- Ofron këshilla për çështjet e protokollit, përfshirë praktikën dhe procedurat e BQK-së dhe ndihmon në sigurimin e administrimit të saktë të pjesëmarrjes në takime dhe ngjarje nga personalitetet e nivelit të lartë;
- Koordinohet me akterët kryesorë për të lehtësuar aranzhimet e mbërritjes dhe largimit për vizitat dhe personalitetet e nivelit të lartë;
- Përveç efikas në cilësi, angazhohet në shtim të efikasitetit të punëve të fushës përkatëse duke aplikuar iniciativë të reja për ngjarjet dhe menaxhimin e protokollit;
- Planifikon vizita, ceremoni dhe ngjarje të veçanta të huaja dhe të brendshme;
- Bën përpilimin dhe dërgimin e ftesave;
- Krijon aranzhime të përshtatshme për ulëset;
- Merr pjesë aktive në organizimin e konferencave të shtypit dhe organizon mundësi fotografimi dhe marrje të pamjeve për mediat gjatë ngjarjeve dhe është bartës i protokollit gjatë konferencave;
- Zhvillon itinerare dhe agjenda;
- Organizon akomodime për strehim dhe takime.
- Parandalon shkeljet e kodit të mirësjelljes ose gabimeve ceremoniale dhe kulturore.
- Mban një listë të drejtuesve kryesorë të bankave qendrore dhe zyrtarëve qeveritarë.
- Kryen detyra të tjera të kërkuara nga Guvernatori apo personeli i caktuar nga Guvernatori.

Njohurit e kërkuara:

- Diplomë universitare nga fusha e ekonomisë, juridikut ose menaxhimi i biznesit;
- Aftësi të mira ndërpersonale;
- Aftësi të mira komunikimi verbal dhe në të shkruar;
- Njohuri të shkëlqyeshme të aplikacioneve të MS Office;
- Njohja e gjuhës angleze.

Përvoja e kërkuar:

- Së paku tre vite përvojë pune në lëmin e protokollit;

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga institucioni/organizata kompetente e mbështetur me dëshmi nga Trust apo ATK;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **19 mars 2021**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.**



OGLAS O SLOBODNOM RADNOM MESTU

Naslov: Viši službenik protokola
Odeljenje: Kabinet guvernera
Stepen: 5
Izveštava kod: Guvernera

Sažetak dužnosti i odgovornosti:

- Planira, razvija, upravlja i izvršava ključne događaje koje organizuje CBK;
- Na položaju Višeg službenika za protokol CBK-a, osigurava da se protokoli razumeju i primenjuju na svim sastancima i događajima CBK-a;
- Razvija i sprovodi politike, strategije, uputstva i procedure u vezi sa upravljanjem Protokolom CBK-a;
- Daje savete o stručnim politikama u vezi sa protokolom, događajima i pitanjima logistike;
- Osigurava uputstva za više osoblje, uključujući guvernera, o posetama na visokom nivou i službenim posetama, uključujući razvoj programa i protokole događaja;
- Pružava savete o pitanjima protokola, uključujući prakse i procedure CBK-a, i pomaže u osiguravanju tačne administracije prisustva na sastancima i događajima od strane ličnosti visokog nivoa;
- Koordinira sa glavnim akterima radi olakšavanja aranžmana dolaska i odlaska za posete i ličnosti visokog nivoa;
- Pored efikasnosti u kvalitetu, bavi se i povećanjem efikasnosti rada na odgovarajućem polju primenom inovativnih inicijativa za događaje i upravljanje protokolom;
- Planira posebne strane i unutrašnje posete, ceremonije i događaje;
- Sastavlja i šalje pozivnice;
- Stvara odgovarajuće aranžmane za sedišta;
- Aktivno učestvuje u organizaciji konferencija za štampu i organizuje mogućnosti fotografisanja i uzimanja kadrova za medije tokom događaja i nosilac je protokola tokom Konferencija;
- Izrađuje itinerare i agende;
- Organizuje akomodaciju za smeštaj i sastanke.
- Sprečava kršenje kodeksa ponašanja ili ceremonijalnih i kulturnih grešaka
- Održava listu glavnih rukovodilaca Centralne banke i vladinih službenika.
- Obavlja druge dužnosti koje zahteva guverner ili osoblje koje odredi guverner.

Potrebna znanja:

- Univerzitetska diploma iz oblasti ekonomije, prava ili upravljanja biznisom;
- Dobre međusobne sposobnosti;
- Dobre verbalne i pisane sposobnosti komunikacije;
- Odlično poznavanje aplikacija MS Office;
- Poznavanje engleskog jezika.

Potrebno iskustvo:

- Najmanje tri godina radnog iskustva u oblasti protokola;

Svi kandidati moraju poslati sledeće dokumente:

- Službeni obrazac CBK-a za apliciranje;
- Propratno pismo (motivaciono) u kome se ističe interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu izdat od nadležne institucije/organizacije potkrepljen dokazima Trust-a ili PAK-a;
- Kopije diploma. Diplome stečene izvan Republike Kosovo MONT mora službeno da ih prizna/nostrifikuje;
- Dokazi o identitetu i stalnom prebivalištu na Kosovu.

Procedura apliciranja:

- Posljednji rod za apliciranje je **19. mart 2021. godine**.
- Apliciranje se može izvršiti online (<https://hris.bqk-kos.org>) putem službene internet stranice CBK-a ili putem arhive CBK-a, br:8. Nijedan drugi oblik apliciranja neće biti uzet u obzir.
- Obrazac za aplikaciju možete preuzeti putem službene interne stranice : www.bqk-kos.org
- Nepotpuna dokumentacija se neće uzeti u obzir.**

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Proton Group" SH.P.K. ka marrë vendim të shuaj biznesin me nr. 811495143 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavje se svi klienti da drustvo sa "Proton Group" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nr. 811495143, ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Proton Group" L.L.C. has come to the decision to quit its nr. 811495143, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Cini Oil" Sh.p.k Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për piken e karburantit naftë, benzinë dhe gazë naftor në Dushanovë komuna e Prizrenit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 02.04.2021 në ora 11:00 në hapësirat e restaurantit të Pompës së karburantit të kompanisë „CINI OIL" SHPK e cila gjindet në kilometrin e tretë në Magjistralen Prizren -Gjakovë në Dushanovë komuna e Prizrenit.do të organizohet debat publik nga kompania "Cini Oil" Sh.p.k Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për piken e karburantit naftë, benzinë dhe gazë naftor në Dushanovë komuna e Prizrenit.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=UmQvcFNU NGQrZVFOM3RnU0d2K283Zz09>

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT**SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Auto Shkolla "Trimi" SH.P.K. me numër UNIK Identifikues: 811384932 Gjilan, bënë zbritje 40% për kandidatët nga data 06.03 deri më 30.03.2021.

▶ "Toni" SH.P.K. Fabrika e Mobileve shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 3303511081. Bejtush Ramadani, Gjilan.

▶ "Inside" N.T.P. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së.

Gent Pllana shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 6-9 të shkollës fillore "Enver Hadri"

▶ Sadije Ferizi shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 8-të të shkollës fillore "Fazli Grajqevci"

▶ Refki Brahimi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Bislim Imeri"

▶ Islam Bollopoja shpall të pavlefshme diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani"

▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

